



ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council

Udhëzime për BUXHETIMIN E PËRGJEGJSHËM PËR KOMUNITETIN ROM



Botuesi: Regional Cooperation Council Roma Integration 2020 Action Team

Ruzveltova 61, 11 000 Belgrade, Serbia

Tel: +381 (11) 4046 891

Fax: +381 (11) 4046 894

E-mail: romaintegration2020@rcc.int

Website: rcc.int/romaintegration2020/

Redaktori: Orhan Usein

Redaktorë të tjerë: Aleksandra Bojadjijeva, Danilo Smolović dhe Rezart Xhelo

ISBN: 978-86-81358-01-6

Deklaratë: Opinonet e shprehura në këto udhëzime nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal ose pjesëmarrësve të tij, as të Bashkimit Europian apo Fondacionit të Shoqërisë së Hapur.

Udhëzime për Buxhetimin e Përgjegjshëm për Komunitetin Rom

Dhjetor, 2018

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| <i>Fjalor i shkurtër</i> | 8 |
| <i>Hyrje</i> | 12 |
| <i>Përfitimet nga zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom</i> | 16 |
| <i>Parakushtet për buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom</i> | 18 |
| <i>Palët e interesuara me rolet dhe përgjegjësitë e tyre</i> | 19 |
| <i>Të kuptuarit e kontekstit të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom</i> | 22 |
| <i>Hapat në buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom</i> | 24 |
| 1. Klasifikimi i programeve buxhetore | 25 |
| 2. Analiza e përputhshmërisë së përmbajtjes së programeve | 30 |
| 3. Analiza e buxhetit | 39 |
| 4. Vlerësimi i ekzekutimit të buxhetit | 47 |
| 5. Përmbledhja e buxhetimit të përgjegjshëm për romët | 53 |
| <i>Trajnimi, rritja e kapaciteteve dhe mbështetja</i> | 58 |

Fjalor i shkurtër¹

Buxheti i zërave të shpenzimit: Një buxhet që bazohet në zëra të ardhurash dhe shpenzimesh sipas klasifikimit ekonomik standart. Zërat buxhetorë (referuar po ashtu edhe si 'objekte shpenzimi') janë thjeshtë mënyra për të klasifikuar llojet e ndryshme të shpenzimeve. Në nivelin më të thjeshtë, kategoritë kryesore të zërave buxhetorë janë si në vijim: shpenzime për personelin, shpenzime operative dhe për mirëmbajtjen, dhe shpenzime kapitale. Sistemet e klasifikimit janë bërë mjaft komplekse. Një buxhet i bazuar tek zërat buxhetorë gjurmon saktësisht paratë e harxhuara për një lloj të veçantë shpenzimi.

Buxhete në bazë programi (dhe performance): Buxhete mbi bazën e programit dhe të performancës synon të përmirësojë efikasitetin dhe efektshmërinë e shpenzimeve publike. Ai lidh financimin e sektorit publik me rezultatet që arrihen, duke përdorur në mënyrë sistematike informacionin mbi performancën. Forma më e thjeshtë e buxhetit mbi bazën e programit dhe të performancës synon të sigurojë që vendim-marrësit kryesorë sistematikisht të marrin parasysh rezultatet që duhet të arrihen nga ky shpenzim, kur hartojnë buxhetin publik. Kjo është një mënyrë për të përmirësuar priorizimin e shpenzimeve, si dhe për të inkurajuar zhvendimin më efikas të fondeve dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e performancës. Buxhete mbi bazën e programit dhe të performancës përputhet në mënyrë të natyrshme me kuadrin e një buxheti afatmesëm. Mënyra më e mirë për të përmirësuar formulimin e një politike që bazohet tek shpenzimet është të përdorë në mënyrë maksimale informacionin mbi performancën dhe të marrë në konsideratë ndërlidhjet afatmesme të kostove për zgjedhjet e shpenzimeve.

Klasifikimi ekonomik dhe funksional: Në varësi të llojit të shpenzimit, ashtu siç është përkufizuar edhe në Statistikat Financiare Qeveritare (SFQ),² 'shpenzimi' është një zvogëlim neto që rrjedh nga kryerja e një transaksioni. Sistemi SFQ i klasifikon 'transaksionet e shpenzimit' në dy mënyra, ku njëra bazohet mbi një klasifikim ekonomik dhe tjetra bazohet mbi një klasifikim funksional. Kur komuniteti furnizohet me mallra jotregu dhe shërbime, një njësi qeveritare mund t'i prodhojë mallrat dhe shërbimet vetë dhe t'i shpërndajë ato, t'i blejë ato nga një palë e tretë dhe t'i shpërndajë ato, ose të transferojë para në dorë tek familjet, në mënyrë që këta të fundit të mund t'i blejnë mallrat dhe shërbimet në formë të drejtëpërdrejtë. Klasifikimi ekonomik identifikon llojin e shpenzimit të kryer për këto veprimtari ndërsa klasifikimi funksional jep informacione mbi qëllimin e kryerjes së këtij shpenzimi.

Klasifikimi sipas programeve: Me qëllim që të mbështesë planifikimin efikas dhe të efektshëm të burimeve në dispozicion, për prezantimin e buxhetit përdoret një grup kategorish të strukturuara në mënyrë hierarkike. Kategoritë janë krijuar me qëllim që të grupohen së bashku të gjitha aktivitetet që shërbejnë për arritjen e rezultateve finale të njëjta. Qëllimi i klasifikimit të programit është të harmonizojë e të lidhë planifikimin strategjik, planifikimin afatmesëm, si dhe përgatitjen e buxhetit sa më mirë që të jetë e mundur. Kjo lidhje mundëson që buxheti të bazohet mbi informacionin

¹ Këto përkufizime janë marrë nga manuali i Programimit të Buxhetit, që është zhvilluar sipas Projektit të Binjakëzimit MK11 IB FI 01. Gjetet tek www.finance.gov.mk/files/u6/Manual%20Programme%20%20%20%20%20Budgeting_final.pdf

² Gjetet tek: www.imf.org/external/pubs/ft/gfs/manual/gfs.htm

për arritjen e rezultateve, dhe lidhjen e drejtëpërdrejtë të arritjeve me mjetet e përdorura. Në mënyrë hierarkike, kjo gjë mund të konceptohet si një program me shumë nivele, i cili bazohet mbi klasifikimin e shpenzimeve, aty ku zonat prioritare ndahen në programe dhe ku programet ndahen më tej në nënprograme (për ekonomitë ku aplikohet) të niveleve më të ulëta.

Fusha e politikës (politika e sektorit): Fusha e politikës synon të arrijë të njëjtat objektiva të përgjithshme, dhe përbën nivelin më të lartë të strukturës së klasifikimit të programit. Ajo paraqet qëllimet dhe objektivat që synohen të arrihen në periudhën afatgjatë dhe afatmesme respektivisht. Fushat e politikave janë kategori të shpenzimeve që bazohen mbi grupe produktesh dhe rezultatesh të ndryshme, të cilat ndajnë të njëjtin objektiv të përgjithshëm, e që zakonisht kanë të bëjnë me një ndikim në shoqëri ose me një rezultat të përgjithshëm. Politikat e sektorit lidhen me shpenzimet nëpërmjet kostimit të produkteve, të cilat realizohen nëpërmjet kryerjes së aktiviteteve, për arritjen e një qëllimi afatgjatë dhe realizmin e objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm. Politikat e sektorit i lejojnë vendim-marrësit, qytetarët dhe taksapaguesit të shohin se cilat politika janë ndjekur dhe cilat shërbime publike dhe veprimtari janë pjesë e këtyre politikave, si edhe ç'shuma parash janë shpenzuar për secilën prej tyre. Për këtë arsye, fushat e politikave (politikat e sektorit) nuk ndjekin strukturën organizative të institucioneve, por secila prej tyre mbulon fusha të veçanta që kanë të bëjnë me ministri të ndryshme dhe përdorues të ndryshëm të buxhetit.

Me qëllim që të sigurohen përgjegjësi të qarta, caktohet vetëm një ministri dhe një ministër që do të jetë në krye të kësaj politike sektoriale, duke u bazuar në pjesën më të madhe të veprimeve dhe masave që ndërmerren brenda për brenda politikës sektoriale. Kjo ministri dhe ky ministër do të bashkëpunojnë me përdoruesit e tjerë të buxhetit të kësaj politike sektoriale, si dhe do të jenë edhe lidhja mes tyre dhe Ministrisë së Financave.

Programi: është një grup veprimtarish të njësisë së qeverisjes qendrore që administrohen efektivisht dhe kontribuojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme, të cilat ndihmojnë, drejtëpërdrejt ose tërthorazi, në arritjen e objektivave dhe të qëllimeve të politikës buxhetore së tij. Një program (mund të) përbëhet nga nënprograme, të cilat përfshijnë fusha të shërbimeve dhe aktiviteteve publike që shërbejnë për të njëjtin qëllim dhe që synojnë të njëjtat objektiva specifike. Programet formojnë nivelin e dytë të klasifikimit të programeve. Secili program i dedikohet qartësisht një politike sektoriale, duke mbështetur objektivat e saj të përgjithshme. Programet duhet të kombinojnë të gjitha veprimtaritë, shërbimet, produktet, transfertat, pagesat dhe projektet që i shërbejnë të njëjtit qëllim dhe që synojnë të njëjtin objektiv specifik (pavarësisht nga burimi i të ardhurave) e që janë të matshme përmes treguesve të përbashkët të rezultatit.

Nënprogrami: Një grup më specifik veprimtarish, projektesh dhe/apo masash që synojnë të arrijnë rezultate më konkrete dhe produkte më të drejtëpërdrejtë. Përkufizimi për termin nënprogram ndjek të njëjtat rregulla që janë përkufizuar edhe për fjalën program, por ato kanë një qasje më praktike. Çdo nënprogram i caktohet një programi të vetëm dhe mbështet objektivat specifike të tij. Objektivat dhe treguesit e nënprogramit tek politika sektoriale duhet të jenë të strukturuara në mënyrë hierarkike që të mbështesin qeverinë dhe procesin e vendim-marrjes dhe të priorizimit nga ana e përdoruesve të buxhetit (politike dhe menaxheriale).

Objektivi: Objektivat përshkruajnë situatën përfundimtare që dëshirohet të arrihet përmes veprimtari të qeverisë. Objektivat u japin mundësi përdoruesve të buxhetit të planifikojnë dhe të organizojnë punën e tyre në përputhje me ndikimet, produktet dhe rezultatet paracaktuara për t'u

arritur. Objektivat përcaktohen për çdo nivel të klasifikimit të programit. Niveli më i lartë hierarkik janë objektivat e përgjithshëm të politikës sektoriale ose objektivat për ndikimin. Niveli i dytë përbëhet nga objektivat më specifike të programeve apo rezultateve, të cilat japin kontributin e tyre në arritjen e objektivave të ndikimit. Niveli i tretë i nënprogrameve përcakton rezultatet e dëshiruara që japin kontributin e tyre në arritjen e rezultateve përfundimtare; këto të fundit janë qartësisht të lidhura me veprimtaritë që prodhojnë rezultatet e masave ose projekteve. Hierarkia e objektivave (zinxhiri i rezultateve) i ndihmon përdoruesit e buxhetit dhe Ministrinë e Financave të identifikojnë pse janë arritur apo jo objektiva të caktuara dhe se si mund të përmirësohet performanca në të ardhmen.

Kur përcaktohen objektivat dhe synimet, përdoruesit e buxhetit (ministritë përkatëse dhe institucionet buxhetore) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave duhet të ndjekin parimet e përcaktimit të objektivave S.M.A.R.T.




Treguesit: Këto janë matje që ndryshojnë në vlerë. Treguesit janë kriteret realiste dhe të matshme, të cilat përdoren për të vlerësuar zhvillimin e programit drejt arritjes së objektivave të tij. Treguesit mund të jenë sasiorë ose cilësorë. Ato duhet të përcaktohen përpara se të fillojë programi dhe vlera e tyre në këtë fazë quhet vlera bazë. Ndryshimet në vlerën e treguesit gjatë zbatimit të programit, të krahasuara me vlerën bazë, tregojnë zhvillimin/suksesin e ndërhyrjes në këtë politikë, ose ndryshimin/dallimin që po krijon programi. Treguesit përcaktohen për çdo nivel të klasifikimit të programit, p.sh. ndikimi, përfundimi, rezultati dhe produkti. Ata sigurojnë prova që diçka ka ndodhur, qoftë ky një produkt i ofruar, ndodhja e një efekti të menjëhershëm apo ndryshimi afatgjatë që vihet re, në përputhje me hierarkinë e objektivave. Të dhënat që kërkohen për të identifikuar vlerën e treguesit duhet të mblidhen dhe të raportohen/botohen në mënyrë periodike. Rekomandohet që treguesit e nivelit më të lartë të jenë të krahasueshëm ndërkombëtarisht (p.sh. përdorimi i pozicionit dhe standarteve të botuara nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik, Banka Botërore, etj...),³

Tregues kyç i performancës (TKP) nënkupton njësinë e matjes së ndikimit, rezultatit dhe produktit. Ata mund të jenë sasiorë ose cilësorë. Vlera e tyre në fillim të zbatimit të një politike quhet vlera bazë. Vlera bazë reflekton gjendjen specifike të situatës shoqërore, ekonomike, ose të tjera, përkundrejt së cilave krahasohet ecuria e politikave. Baza zakonisht matet nga treguesi i performancës në nivel rezultati/produkti, i cili reflekton vlerën bazë para zbatimit të politikës. Vlera bazë duhet të përlloraget duke përdorur informacion nga burimet zyrtare statistikore.

³ Më shumë detaje shpjeguese mund të gjenden në: <https://commdev.org/userfiles/Hierarchy%20of%20Indicators%20for%20CI%20projects.pdf> and www.imf.org/external/pubs/ft/tnm/2009/tnm0901.pdf

Projekti: Një projekt është një tërësi ekonomike dhe pandashme aktivitete që përbushin me saktësi një funksion (teknik/teknologjik) me objektiva të përcaktuara qartë, të cilat përbëjnë bazën për të përcaktuar nëse projekti i plotëson kriteret e paracaktuara. Një projekt ka një jetëgjatësi të përcaktuar, e cila është e kufizuar nga data e fillimit dhe data e përfundimit. Një projekt është një tërësi veprimtarish me një qëllim të veçantë përmes të cilave mjetet e ndryshme (financiare, materiale, njerëzore, koha dhe burimet e tjera) shpenzohen me qëllim që të arrihen objektivat apo përfitimet e përcaktuara.

Masa (masa publike/e politikës): Një masë përbëhet nga një sërë veprimtarish të rëndësishme të ndërlidhura, (aktivitete ose projekte) të cilat ndërmerren me pikësynimin e arritjes së objektivit të përcaktuar në një politikë publike. Një masë e politikës mund të ndërlidhet me çdo nivel të hierarkisë së klasifikimit të programit ose me funksionimin e rregullt të një autoriteti/shërbimi publik. Lloji i masës mund të jetë rregullatore, stimuluese, institucionale, furnizimi i mallrave, ofrimi i shërbimeve, etj. Ajo mund të jetë e kufizuar ose jo në kohë ose në objektiv (synim) dhe të shërbejë për të sjellë një ndryshim të caktuar për një grup të synuar specifik.



Cikli i buxhetit: I referohet procesit me anë të së cilit qeveria krijon, miraton, ekzekuton, kontrollon dhe vlerëson buxhetin publik, siç tregohet më poshtë.

Vlerësimi i ndikimit: Ky është një proces për vlerësimin e ndikimit të mundshëm të një ndërhyrjeje të propozuar në politikë. Ai merr në konsideratë ndikimet e ndërlidhura social-ekonomike, kulturore dhe shëndetësore, qofshin këto fitimprurëse ose jo.

Hyrje

Udhëzimet për Buxhetimin e Përgjegjshëm për Komunitetin Rom janë rezultat i punës së Grupit Ndërqeveritar të Punës për Buxhetimin e Përgjegjshëm për Komunitetin Rom, të mbështetur nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal përmes Ekipit të Planit për Integrimin e Romëve 2020 (Roma Integration 2020 Action Team). Ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të detyruara të caktojnë burime të nevojshme për politikën e përgjithshme dhe të synuara, të cilat do të sigurojnë integrimin efikas të komunitetit rom. Zbatimi i Udhëzimeve për Buxhetimin e Përgjegjshëm për Komunitetin Rom, (që këtej e tutje, Udhëzimet), do të sigurojë që qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor të përfshijnë dhe të ofrojnë qëllime specifike për integrimin e komunitetit rom në zhvillimet e politikave të tyre të përgjithshme, duke krijuar një lidhje mes këtyre synimeve dhe buxheteve publike. Qëllimi i krijimit të një lidhjeje të tillë është i dyfishtë: së pari, do t'i bëjë politikën e përgjithshme social-ekonomike më të ndjeshme e më reaguese ndaj nevojave të komunitetit rom, duke siguruar kështu një barazi më të madhe në rezultatet e këtyre politikave; dhe, së dyti, do të kontribuojë për buxhetimin dhe realizimin e përshtatshëm të synimeve të integritit të komunitetit rom si pjesë e shërbimeve të përgjithshme publike.

Udhëzimet janë përgatitur kryesisht për qeveritë në rajon, veçanërisht për ministritë e linjës përgjegjëse për fushat e ndryshme prioritare të integritit të komunitetit rom, dhe janë të rëndësishme për Ministritë e Financave. Këto institucione duhet të jenë në gjendje të njohin dhe të sigurojnë një reagim të përshtatshëm për promovimin e integritit të komunitetit rom kur përgatisin dhe miratojnë propozime politikash dhe masa konkrete, qofshin ato politika të përgjithshme social-ekonomike, ose politika që specifikisht synojnë komunitetin rom.

Qëllimi përfundimtar është të sigurohet barazia për komunitetin rom duke zvogëluar hendekun social dhe ekonomik mes këtij komuniteti dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Ky qëllim arrihet vetëm përmes përfshirjes së përshtatshme të integritit të komunitetit rom në politika dhe shërbime publike të përgjithshme. Një sërë politikash të përgjithshme janë të lidhura me romët, dhe për këtë arsye mund të monitorohet pjesëmarrja e komunitetit rom në politika të tilla, me qëllim që të përcaktohet nëse sjellin rezultate të njëjta për pjesëtarët e këtij komuniteti ashtu si edhe për qytetarët e tjerë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për përpjekje shtesë me qëllim që të arrihen rezultate të barabarta për romët si dhe për qytetarët e tjerë për një sërë politikash kryesore.

Përpjekje të tilla mund të grupohen në tri kategori:

- ✳️ **përpjekje në terren** për të ndryshuar kriteret për përfituesit, me qëllim që të sigurohet që shërbimet publike arrijnë në mënyrë të barabartë edhe tek komuniteti rom ashtu siç arrijnë edhe tek persona të tjerë në një situatë të ngjashme,
- ✳️ **përpjekje afirmative** për të caktuar një pjesë të dedikuar të shërbimeve publike për komunitetin rom, me qëllim që të sigurohen mundësi të barabarta,
- ✳️ **përpjekje përshtatëse** për të ndryshuar ose futur shërbime të reja publike të përshtatura ndaj rrethanave specifike të komunitetit rom dhe personave të tjerë në një situatë të ngjashme.

Kjo gjë do të lejojë përmbushjen e qëllimeve të politikës për integrimin e komunitetit rom si edhe të qëllimeve të politikave të përgjithshme social-ekonomike dhe shmangien ndërkohë të përsëritjes së politikave dhe të burimeve njerëzore e materiale. Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom do të thotë që alokimi i fondeve për integrimin e këtij komuniteti bëhet përmes shpenzimeve ekzistuese në politikën e përgjithshme në kundërshtim me caktimin e një buxheti shtesë të synuar veçanërisht për integrimin e romëve (megjithëse një buxhet i veçantë ndoshta mund të kërkohej me qëllim që të adresojë rrethana specifike apo boshllëqe të thella).

Udhëzimet propozojnë një cikël prej pesë hapash kryesore për të arritur buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom, siç paraqiten më poshtë.

1. Klasifikimi i programeve buxhetore

Klasifimi bëhet nëpërmjet analizës së buxhetit që mbështet krijimin e një lidhjeje mes programeve buxhetore publike dhe procesit të integritit të komunitetit rom. Lidhja mund të jetë e drejtëpërdrejtë, jo e drejtëpërdrejtë ose të konsiderohet neutrale. Programet buxhetore të lidhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë janë ato programe që i referohen në mënyrë të posaçme nevojave të menjëhershme të komunitetit rom. Programet e buxhetit të lidhura në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë nuk i referohen në mënyrë të veçantë komunitetit rom, por mund të supozohet që ato janë të rëndësishme për këtë komunitet, meqënëse ato janë të përshtatshme për individë që bëjnë pjesë në kategorinë e kriterit përfitues (duke përfshirë kështu edhe komunitetin rom). Zërat e buxhetit neutral, si grupi i tretë, janë ato që në pamje të parë nuk kanë lidhje me qëllimet për integrimin e komunitetit rom.

2. Analiza e përputhshmërisë së përmbajtjes së politikës

Pas kryerjes së klasifikimit të programeve buxhetore është e nevojshme të bëhet një krahasim me politikën e integritit të komunitetit rom përsa i përket objektivave, treguesve dhe aktivitetëve. Një krahasim i tillë kërkon studimin e shpjegimeve të buxhetit dhe të dokumenteve të politikës. Nëse kërkohej informacion shtesë, ai duhet të merret nga personat përgjegjës për analizimin e programeve buxhetore. Qëllimi është që të përcaktohet një nivel sinkronizimi mes programeve buxhetore të analizuar dhe politikës për integrimin e komunitetit rom.

3. Analiza e buxhetit

Në këtë hap, bëhet analiza e buxhetit me qëllim që të arrihen përfundime të thelluara lidhur me përshtatshmërinë e buxhetit të caktuar për politikën e integritit të komunitetit rom dhe objektivave të saj. Në këtë kuptim, krahasohen të dhëna të ndryshme me qëllim që të vlerësohet nëse buxheti i caktuar për politikën e integritit të komunitetit rom korrespondon me: buxhetin e planifikuar në dokumentet e politikës së integritit të romëve, objektivën e politikës së integritit të komunitetit rom dhe se deri në çfarë mase ai kontribuon tek objektivi i një politike më të përgjithshme dhe tek buxheti i alokuar për këtë qëllim. Ky është një hap i rëndësishëm në vlerësimin e qëndrueshmërisë së planifikimit të buxhetit, për të parë nëse alokimet buxhetore janë të përshtatshme dhe se çfarë përmirësimesh duhen kryer. Angazhimi i ministrive të linjës dhe Ministrisë së Financave është thelbësor për sigurimin e informacionit përkatës që kërkohej për të bërë analizën.

4. Vlerësimi i ekzekutimit të buxhetit

Ndërkohë që hapat e mësipërm i referohen procesit të planifikimit të buxhetit, ky hap merret me zbatimin e buxhetit dhe se si ndikon kjo gjë në arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e integritetit të komunitetit rom dhe në politikën e përgjithshme që i korrespondon programit buxhetor të analizuar. Vlerësimi krahason kontributet buxhetore me produktet dhe rezultatet e politikës. Për këtë hap, është e rëndësishme të përcaktohet një sistem i përshtatshëm monitorimi që do të jetë në gjendje të sigurojë të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe etnisë për vlerat bazë, shpenzimet, përfituesit dhe ndikimin e arritur. Kapaciteti absorbues i institucionit zbatues vlerësohet, ndërkohë që tendencat buxhetore (rritja apo zvogëlimi i alokimeve dhe shpenzimeve në buxhet) vlerësohen për mënyrën se si krahasohen ato me tendencat e vërejtura në terren (ndryshimi i situatës së komunitetit rom dhe të popullsisë së përgjithshme). Në bazë të informacionit të mbledhur, ky hap jep të dhëna se si mund të përshtatet planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit, në mënyrë që t'u shërbejë edhe objektivave të përgjithshme, edhe objektivave të synuara për integrimin e komunitetit rom.

5. Përmbledhja e buxhetimit të përgjegjshëm për romët

Hapat e nevojshëm për të promovuar integrimin e komunitetit rom përmes perspektivës buxhetore vendosen mbi bazën e analizave të kryera në hapat e mësipërm, dhe përfshihen në një dokument të vetëm: përmbledhja e buxhetit. Përmbledhja e buxhetit duhet të përgatitet dhe të përditësohet çdo vit. Është më e mundshme që të përgatitet një listë me rekomandime për ndërhyrjet e nevojshme (të tilla si pilotimi i programeve të buxhetimit përgjegjshëm për komunitetin rom, Pika Kombëtare e Kontaktit për Komunitetin Rom të përfshihet në diskutimet për buxhetin të organizuara nga ministritë e linjës, etj.), ndërkohë që duhet të merret gjithashtu parasysh se cilat rekomandime mund të miratohen realisht në atë kohë. Propozimi fillestar është që të pilotohet një numër më i vogël i programeve sipas qasjes me pesë hapa, dhe të përgatiten udhëzime dhe rekomandime specifike mbështetur tek gjetjet e pilotimit.

Udhëzimet bazohen mbi një analizë fillestare të gjendjes të fushave të politikës të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, që njihen më mirë si prioritetet tematike të integritetit të komunitetit rom (arsimi, punësimi, shëndetësia, strehimi dhe disa prioritetet e veçanta të ekonomive), të para nga këndvështrimi buxhetor. Dhe kjo pastaj tërheq vëmendjen tek boshllëqet që duhen zgjidhur. Pavarësisht kësaj, buxhetimi i përgjegjshëm për komunitetin rom duhet të mbulojë gradualisht të gjitha politikat e përgjithshme social-ekonomike dhe masat për këto politika, prej të cilave do të përfitojë komuniteti rom. Në mënyrë korresponduese, pesë hapat e propozuar janë po ashtu të vlefshëm edhe për sektorë të tjerë të politikave, si edhe për grupe të tjera të synuara. Qeveritë duhet të ndjekin edhe më tej analizën e pesë hapave të propozuar për fushat e mbetura të politikës për të garantuar që politikat e planifikuara dhe të zbatuara i përgjigjen kërkesave të integritetit të komunitetit rom.

Duhet theksuar se Udhëzimet përdorin qasje të ngjashme të zhvilluara në sektorë të tjerë, të tillë si: buxhetimi i përgjegjshëm gjinor. Megjithatë, kjo përfaqëson një qasje të re dhe të paprovuar më parë përse i përket çështjes së integritetit të komunitetit rom, dhe për këtë arsye çdo informacion shtesë që do të përfitohet nëpërmjet zbatimit të saj do të prodhojë të dhëna të reja për zhvillimin e mëtejshëm të Udhëzimeve.

Ky është një moment i rëndësishëm për futjen e standarteve të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom, sepse është e mundur të sigurohet mbështetje për reformat buxhetore në vazhdim e sipër në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, reforma të cilat synojnë të fusin buxhetimin në bazë të programit/performancës.

Përfitimet nga zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom

Buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom ofron një gamë të gjerë avantazhesh, të cilat shkojnë përtej integritit shoqëror të këtij komuniteti dhe kontribuojnë me efikasitet në rritjen e përgjithshme brenda për brenda rajonit të zgjeruar.

- ✿ **Një transparencë më e madhe buxhetore që lidhet me vendimet politike të lidhura me buxhetin.**

Buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom siguron një analizë të buxhetit të parë nga perspektiva e integritit të romëve dhe përfaqëson përfshirjen e perspektivës së barazisë për këtë komunitet në të gjitha politikat e të gjitha niveleve dhe e të gjitha fazave në procesin buxhetor. Ai përfaqëson një vlerësim të buxhetit të bërë nga perspektiva e komunitetit rom dhe një ristrukturim të shpenzimeve me qëllim që të promovohet barazia e romëve.

- ✿ **Saktësi dhe qëndrueshmëri më e madhe e fondeve publike, meqë fondet përshtaten më me saktësi për nevojat aktuale të komunitetit rom dhe grupeve të tij (p.sh. të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, gratë dhe vajzat).**

Kuptimi i ndikimit të buxhetit tek popullsia romë kërkon një analizë të thelluar të buxheteve ekzistuese si edhe zbatimin e programeve të politikave që lidhen me integritimin e komunitetit rom. Analiza duhet të vlerësojë lidhjen mes qëllimeve dhe synimeve të integritit të komunitetit rom dhe të programeve të buxheteve të politikës së përgjithshme. Rezultati i një analize të tillë duhet të sigurojë informacion të rëndësishëm se si dhe ku mund të përmirësohen këto lidhje. Po ashtu, analiza duhet të sigurojë të dhëna mbi efikasitetin e kostove të masave që tashmë lidhen drejtëpërdrejtë me buxhetin (marrëdhënia midis burimeve të investuara dhe arritjeve). Përdorimi i të dhënave të marra do të çojë në një investim të bazuar në prova, në prioritizimin e politikave të suksesshme dhe në shpenzimin efikas të burimeve.

Një analizë e ndikimit të buxhetit (e parë nga këndvështrimi i integritit të komunitetit rom) është një vlerësim ekonomik që përllogarit pasojat financiare të miratimit të ndërhyrjes së re (masë apo projekte), ose që vlerëson masën tashmë ekzistuese në kostot e buxhetit. Analiza siguron një kuptueshmëri më të mirë të rezultateve dhe ndikimeve (të matshme nëpërmjet treguesve të ndikimit).

- ✿ **Të dhënat e të gjitha pasojave diskriminuese të vendimeve për financim do të çojnë në vendime edhe më të drejta mbi ristrukturimin e ndarjes së burimeve.**

Kjo vë në pah boshllëqet mes politikave dhe burimeve të dedikuara. Me fjalë të tjera, e kthen vëmendjen në mungesën e integritit në planifikimin strategjik dhe në procesin e buxhetimit. Kur përdoret buxheti i përgjegjshëm për romët, ekonomitë janë, të paktën, në gjendje të përgatisin një hartë të prioriteteve, objektivave dhe rezultateve strategjike dhe lidhjes së tyre me shpenzimet. Kjo e bën më të lehtë përcaktimin e taveve buxhetore në nivel politike dhe përkufizimin e hierarkisë së dokumenteve me përgjegjësi të përcaktuara qartësisht.

Parakushtet për buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom

Buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom kërkon krijimin e një mjedisi të caktuar në mënyrë që të japë rezultatet e dëshiruara. Parakushtet janë përshkruar si më poshtë:

- ✳ **Mirëkuptimi i thellë i integritit të komunitetit rom:** Si do të integrohen çështjet që lidhen me komunitetin rom në politikat e ndryshme, si edhe mundësia për të adresuar çështjet me masa/projekte (të reja apo ekzistuese) specifike. Kjo bëhet e mundur përmes një qasjeje graduale, trajnimit të përdoruesve të buxhetit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve të të gjithë aktorëve të interesuar.
- ✳ **Vullneti politik:** Pushteti ekzekutiv dhe legjislativ duhet të pranojnë nevojën për veprim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për integrimin e komunitetit rom dhe ta komunikojnë këtë gjë në të gjithë administratën publike dhe parlamentin.
- ✳ **Angazhimi financiar:** Integrimi i komunitetit rom nuk mund të arrihet vetëm me anë të politikës dhe/apo strategjisë së qeverisë. Burimet financiare janë të domosdoshme për të mbështetur këtë prioritet qeveritar. Përveç kësaj, angazhimet financiare për integrimin e romëve duhet të përfshihen në punën thelbësore të zyrtarëve të buxhetit nëpër të gjitha institucionet qeveritare /ministrinë.
- ✳ **Krijimi i sistemeve të të dhënave të ndara:** Është shumë e rëndësishme të ketë të dhëna të ndara në të gjitha nivelet ku kërkohet sigurimi i alokimit, shpenzimit dhe monitorimit të efektshëm dhe efikas të fondeve. Roli i zyrës së statistikave është i rëndësishëm për sigurimin e të dhënave përkatëse statistikore social-ekonomike, si për popullatën e përgjithshme, ashtu edhe për popullatën rome.

Palët e interesuara me rolet dhe përgjegjësitë e tyre

Institucionet e përfshira në përgatitjen dhe zbatimin e buxheteve, dhe veçanërisht të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom, janë si në vijim:

- ✳ **Ministria e Financave** luan një rol qendror dhe parësor në çdo buxhetim si edhe në çdo buxhetim të përgjegjshëm. Kjo ministri është në gjendje të ndryshojë qarkoren/udhëzimin e ciklit të buxhetit, të kontrollojë buxhetin e ministrive të linjës përkundrejt udhëzimeve për ciklin buxhetor, të miratojë formatin për çdo pasqyrë buxhetore dhe të botojë pasqyrat e ndryshme buxhetore.
- ✳ **Ministrinë** e linjës janë përgjegjëse për përgatitjen dhe dërgimin e vlerave të parashikuara buxhetore në Ministrinë e Financave dhe për ekzekutimin e buxheteve sipas politikave dhe prioritetëve sektoriale. Ministrinë e linjës duhet të marrin në konsideratë gjetjet e studimeve specifike mbi integrimin e komunitetit rom kur ato formulojnë politikat dhe përgatisin buxhetet. Ato përgatisin dokumente që janë në përputhje me udhëzimin për ciklin buxhetor dhe mund të përgatisin pasqyrat/përmbledhjet e buxhetimit të përgjegjshëm për romët në lidhje me prioritetet e tyre tematike përkatëse.
- ✳ **Zyra e Kryeministrit dhe/apo e Zëvendëskryesministrit** është përgjegjëse për vendimet/diskutimet përfundimtare mbi prioritetet strategjike.
- ✳ **Ministri apo zyrtarë të tjerë të lartë nga sektori i çështjeve sociale, të drejtave të njeriut/minoriteteve, apo sektorëve të tjerë përkatës, përgjegjës për integrimin e romëve** në nivel të të gjithë qeverisë bashkërendon dhe monitoron procesin e përgjithshëm të integritit të romëve, dhe, po ashtu, duhet të kenë detyrën të udhëheqin iniciativën e buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom.
- ✳ **Organet e vetëqeverisjes vendore** dhe ndërmarrjet publike që marrin fonde nga buxheti publik dhe që kanë lidhje me përmirësimin e statusit të komunitetit rom. Këto organe kanë detyra në planifikimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit. Me kohë, buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom duhet të përdoret edhe në nivelin vendor, mundësisht duke filluar me pilotimin e tij në dy bashki/komuna të përzgjedhura.
- ✳ **Parlamenti** miraton buxhetin publik mbi bazën e propozimit të qeverisë. Deputetët e parlamentit mund të ndikojnë në përmbajtjen e buxhetit përmes komisioneve, negociatave

të koalicionit, etj., për të përfshirë përmbajtjen e propozuar përmes buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom.

- ✳️ **Organizatave e shoqërisë civile, studjuesit, akademikët dhe grupet** e tjera të interesit janë partnerë të rëndësishëm dhe duhen konsultuar gjatë fazës përgatitore, dhe duhet të përfshihen në monitorimin e ekzekutimit të buxhetit. Në disa raste, këta partnerë mund të veprojnë edhe si zbatues të masave (për shembull, duke aplikuar dhe zbatuar projekte të financuara nga Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA)).
- ✳️ **Zyra e Statistikave** duhet të nxjerrë të dhëna dhe statistika kombëtare për treguesit e ndikimit të politikës.
- ✳️ **Media** duhet të përfshihet në promovimin e buxhetimit të përgjegjshëm për romët.

Integrimi i komunitetit rom aktualisht po buxhetohet përmes planeve të veprimit për integrimin e romëve, të cilat ndonjëherë devijojnë ose nuk janë tërësisht të sinkronizuara me buxhetet e ministrive përkatëse të linjës. Rrjedhimisht, ministritë e linjës nuk zbatojnë masat për integrimin e plotë të komunitetit rom.

Shkalla në të cilën integrimi i komunitetit rom lidhet drejtëpërsëdrejti me programet dhe reformat buxhetore përta i përket buxhetimit të bazuar në programe ndryshon mjaft në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ekonomitë janë në faza të ndryshme të reformës së financave publike dhe disa prej tyre janë duke përdorur tashmë Kuadrin Afatmesëm të Buxhetit/Shpenzimeve dhe buxhetimin në bazë të programit/performancës, ndërkohë që disa të tjerë aktualisht janë duke përcaktuar elementët bazë të këtij lloji buxhetimi. Praktika e buxhetimit mbetet ende fuqimisht e ndikuar nga tavanët e buxhetit të përcaktuar nga ministritë e financave dhe nga mungesa e informacioneve përmbledhëse dhe të ndara mbi përfituesit dhe marrësit përfundimtarë. Ciklet e papërshtatura të buxhetimit, përta i përket planifikimit dhe zbatimit në kohë, si dhe situatat e veçanta në ekonomi dhe në sektorë ushtrojnë ndikim në faktin që buxheti aktual është në një masë të madhe i rikrijuar nga viti në vit pa justifikimet e duhura. Për shkak të sfidave të tilla sistematike në buxhetim, integrimi i komunitetit rom duket se varet në masë të madhe nga financimet e donatorëve. Për më tepër, programet dhe masat për integrimin e popullsisë së përgjithshme dhe e komunitetit rom nuk vlerësohen nga perspektiva e ndikimit që ato kanë mbi këtë komunitet.

Dy janë parakushtet kryesore që duhet të përmbushen me qëllim që të përcaktohet shkalla e përmbushjes së objektivave të integrimit të komunitetit rom dhe të matet ndikimi i tyre:

- **Prezantimi i objektivave të qarta dhe të strukturuar mirë, i synimeve realiste, i afateve kohore të arritshme dhe i alokime të planifikuara të buxhetit për integrimin e romëve.**
- **Prezantimi i treguesve të përshtatshëm dhe i të dhënave statistikore të besueshme të ndara.**

Përmbushja e këtyre parakushteve do të lehtësonte kryerjen e vlerësimeve të politikës përpara dhe pas zbatimit të saj.

Aktualisht, duhet të merren në konsideratë mangësitë e mëposhtme, të cilat mund të kufizojnë aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom:

- ✳️ Objektivat, përfshirë këtu edhe ndikimin, arritjet, rezultatin dhe objektivat për produktin nuk janë strukturuar në mënyrën e duhur.
- ✳️ Në disa nivele, objektivat nuk janë përcaktuar ose janë prezantuar objektiva të papërshtatshme. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur bëhet fjalë për përcaktimin e synimit.
- ✳️ Afatet kohore nuk janë përcaktuar qartësisht (mbetet e paqartë në ato lidhen me një vit të veçantë ose me të gjithë periudhën kohore të përcaktuar në dokumentin e kësaj politike).
- ✳️ Synimet janë shpesh jo realiste dhe disa herë nuk janë përcaktuar fare.
- ✳️ Burimi i financimit nuk është i saktë (buxhetet e planifikuara nuk korrespondojnë me alokimet e miratuara të buxhetit të institucioneve kompetente).
- ✳️ Përcaktohen tregues jo të përshtatshëm (performanca kryesore) për të gjithë zinxhirin e rezultateve (ndikimi, arritjet, rezultatet dhe produktet).
- ✳️ Ka një mungesë të të dhënave bazë statistikore të ndara dhe të të dhënave periodike, në veçanti për masat kryesore, të tilla si: arsimit, strehimi, punësimi, shëndetësia, etj.
- ✳️ Ka një varësi të madhe ndaj financimeve të donatorëve.
- ✳️ Nuk përgatiten vlerësimet e ndikimit.

Të kuptuarit e kontekstit të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom

Punonjësit përgjegjës në institucionet përkatëse për integrimin e komunitetit rom duhet të kuptojnë ciklin e përgjithshëm të buxhetimit publik.

TË KUPTUARIT E CIKLIT TË BUXHETIT


1. Cili është kuadri ligjor që drejton buxhetimin publik? Lexoni Ligjin për Buxhetin dhe aktet nënligjore korresponduese si dhe udhëzimet mbi buxhetin. Konsultohuni me Ministrinë e Financave për sqarime kur është e nevojshme.
2. Cilat janë procedurat për buxhetimin (afatet kryesore, tavanet/limitet dhe a janë këto të përcaktuara në nivelin e ministrive të linjës apo të politikës sektoriale)? Kur hartohen masat, nënprogramet dhe programet? Cilat institucione dhe dokumente përcaktojnë objektivat, treguesit dhe synimet?

Përveç këtyre, kontrolloni edhe sa më poshtë vijon:

- afatet kohore që lidhen me zhvillimin e buxhetit afatmesëm dhe vjetor dhe kërkesat për konsultime publike;
 - formatin e buxhetit: a është i bazuar tek zërat, tek programi (dhe performanca), ose tek të dyja;
 - datat se kur duhen bërë propozimet dhe kur duhen dhënë argumentet dhe cilit institucion i duhen drejtuar;
 - kalendarin e buxhetit, momentet kryesore dhe çështjet përkatëse që lidhen me inputet;
 - procesin e diskutimit të buxhetit dhe institucionet që mbajnë dhe ekzekutojnë përgjegjësitë kryesore;
 - kriteret ose kufizimet e sistemit dixhital të buxhetimit publik dhe vendim-marrësit;
 - mundësitë dhe procedurat për mbartjen e fondeve/parave të papërdorura (nga zërat e buxhetit, nëpër nënprograme) nga viti në vit;
 - procedurat për fonde të IPA/donorëve, institucioni kryesor përgjegjës për fondet e IPA/të donatorëve dhe metodat për të integruar financimet e donatorëve në procedurat e përgjithshme të buxhetimit;
 - angazhimet lidhur me përvetësimet dhe procedurat që lidhen me to;
 - procedurën dhe institucionet/zyrtarët përgjegjës që vendosin për prezantimin e zërave të rinj të buxhetit ose për ndryshimin e atyre ekzistues.
3. Si përcaktohen prioritetet? Si dhe kur prioritarizohen shpenzimet korresponduese buxhetore? Cili klasifikim përdoret? Si lidhet ai me Programin e Reformës Ekonomike dhe prioritetet e tij?
 4. Cili është formati dhe udhëzimi për buxhetin? Cilët janë elementët kryesorë? A e përmban ai të gjithë informacionin e nevojshëm? A janë të mundura ndryshimet?
 5. Çfarë roli luan parlamenti në buxhetimin publik?
 6. Çfarë ndodh kur nuk ka para të mjaftueshme për të gjitha masat? Si zgjidhet kjo çështje dhe kush e merr vendimin përfundimtar?
 7. Kush mund të riprioritarizojë shpenzimet publike? Si përcaktohet/zbatohet ky proces riprioritarizimi? Cilat janë procedurat për ribalancimin e buxhetit?
 8. Si dhe kur mund të promovohet buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom brenda për brenda procedurave të buxhetit të politikave sektoriale?

Hapat në buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom

Propozohet që buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom të ndjekë qasjen me pesë hapa, siç përshkruhet më poshtë.



Në nënkapitujt e tjerë, pesë hapat shpjegohen përmes pyetjeve dhe shembujve. Këto duhet të merren në konsideratë kur bëhet vlerësimi se deri në çfarë masë procesi i buxhetimit përputhet me aspiratat për të promovuar integrimin e komunitetit rom. Pas kryerjes së vlerësimit, mund të jepen propozimet në lidhje me hartimin, zbatimin dhe rishikimin e buxhetit, me qëllim që buxheti të bëhet më reagues ndaj integritetit të këtij komuniteti. Pikat Kombëtare të Kontaktit të Komunitetit Rom, ministritë e financave, ministritë e linjës dhe institucione të tjera që e kanë për detyrë të planifikojnë dhe buxhetojnë aktivitetet që lidhen me integrimin e komunitetit rom mund të përdorin Udhëzimet për Buxhetimin e Përgjegjshëm për këtë komunitet. Rekomandohet që grupi i punës që ka detyrë të testojë buxhetimin e përgjegjshëm për romët të ngrihet në një fazë të hershme të aplikimit të këtij lloji buxhete. Grupi i punës duhet të përbëhet nga sa më shumë përfaqësues të institucioneve përkatëse qeveritare dhe të ministive të linjës që të jetë e mundur, përfshirë palët e interesuara të përshkruara më parë dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Qëllimi përfundimtar është që ta kthejë buxhetimin e përgjegjshëm për romët në një pjesë integrale të ciklit të buxhetit të përgjithshëm. Me fjalë të tjera, integrimi i romëve duhet të kthehet në një temë të përgjithshme, duke u përfshirë në çdo hap dhe në çdo dimension të procesit të buxhetimit. Rrjedhimisht, ndarja e buxhetit do të tregojë qartësisht se si i përgjigjet dhe ndikon tek nevojat dhe prioritetet e ndryshme të komunitetit rom. Arritja e këtij qëllimi kërkon një proces gradual afatgjatë aplikimi përmes fazave dhe praktikave të ndryshme të ciklit të buxhetit. Në këtë fazë, buxheti i përgjegjshëm për komunitetin rom propozohet si një model i bazuar mbi analizën e gjendjes aktuale. Ai duhet të testohet dhe analizohet edhe më tej nëpërmjet aplikimit të tij, dhe rrjedhimisht, zhvillohet dhe pasurohet. Analiza duhet të nxjerrë në pah gjetje dhe rekomandime konkrete që do të mbështesin ecjen përpara drejt formulimit të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom. Në përputhje me rekomandimet, integrimi i komunitetit rom duhet të lidhet qartësisht dhe gjithnjë e më shumë me buxhetin publik përmes elementëve të veçantë buxhetorë, të tillë si: programet buxhetore, masat, produktet, nënprogramet, linjat buxhetore, treguesit, klasifikimi i shpenzimeve, e të tilla si këto.

Produkti i aplikimit të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom sipas modelit me pesë hapa duhet të jetë një përmbledhje e buxhetimit të përgjegjshëm për këtë komunitet. Kjo përmbledhje e buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom do të jetë një përmbledhje e shkurtër ekzekutive e qasjes me pesë hapa. Ajo mund të miratohet nga qeveria kur bëhet raportimi mbi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Komunitetit Rom, e prezantuar si një përmbledhje brenda dokumenteve të qeverisë që i referohen prioritetëve kombëtarë për zbatimin e buxhetit (të tilla si: memorandum i buxhetit apo strategjia fiskale), ose si një shënim shpjegues në buxhet. Në rast se për ndonjë arsye, nuk mund të paraqitet një përmbledhje formale për buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom, atëherë duhet të paraqitet një raport i veçantë si një alternativë, mundësisht në kohën e miratimit të Kuadrit Afatmesëm të Shpenzimeve. Përmbledhja apo analiza do të paraqesë arritjet në integrimin e komunitetit rom dhe do të përmbajë një analizë krahasuese të qëllimeve, rezultateve dhe shpenzimeve të integritetit të romëve, të përgatitura mbi bazën e analizimit të programeve buxhetore, nënprogrameve, projekteve/aktiviteteve, linjave buxhetore, etj. Pjesa më e rëndësishme e kësaj përmbledhjeje apo raporti duhet të jenë rekomandimet konkrete për buxhetin. Prandaj, kjo përmbledhje do të shërbejë si një raport progresi mbi përdorimin e buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom, do të reflektojë për të gjitha pengesat apo mangësitë lidhur me buxhetin dhe do të përfshijë sugjerime drejt përmirësimeve konkrete të buxhetit. Së fundmi, informacioni i marrë nga përmbledhja duhet të përdoret për të negociuar, bazuar mbi prova, për caktimin e burimeve për integrimin e komunitetit rom në ciklin e ardhshëm të buxhetit. Shkurtimisht, futja e buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom si pjesë e sistemit të buxhetit ka faza të ndryshme dhe është një proces afatgjatë. Pavarësisht faktit që përmbledhjet formale të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom duhen prezantuar, raportet korresponduese të buxhetit duhet të shërbejnë si një produkt i përkohshëm i buxhetimit të përgjegjshëm për romët.

1. Klasifikimi i programeve buxhetore

Me qëllim që të kryhet hapi i parë në buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom, është shumë e rëndësishme të kuptohet mirë politika e integritetit të komunitetit rom. Kjo gjë përfshin dokumentet politikë, kryesisht strategjitë dhe planet e veprimit.

Objetivi i hapit të parë është të klasifikohen programet buxhetore, produktet/nënprogramet dhe aktivitetet /projektet e programit sipas lidhjes që ato kanë me integrimin e komunitetit rom. Për ta bërë më të thjeshtë përshkrimin, termi 'program buxhetor' do të përdoret për t'iu referuar programeve, produkteve/nënprogrameve dhe aktiviteteve/projekteve të programit. Prandaj, procesi i buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom duhet të mendohet që të zbatohet në të gjitha këto nivele të buxhetit. Duhet të vihet në dukje se buxheti aktual mund të ketë më pak ose më shumë nivele, në varësi të ndarjes së programit buxhetor. Po ashtu, duhet theksuar se linjat buxhetore që përfaqësojnë shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik (të tilla si: pagat, investimet kapitale, etj.) ende përdoren brenda buxheteve në rajon. Këtu, linjat buxhetore nuk duhet të merren në konsideratë, sepse ato nuk përmbajnë informacione të rëndësishme për këtë hap.

Çdo program buxhetor duhet të klasifikohet si '1', '2' ose '0', në përputhje me përshkrimin e mëposhtëm.

Kategoria 1. Programi **lidhet drejtëpërdrejtë** me integrimin e komunitetit rom. Programe të tilla shërbejnë për zbatimin e politikës për integrimin e romëve dhe zakonisht titullohen qartësisht si të tilla.

Kategoria 2. Programi **lidhet në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë** me integrimin e komunitetit rom. Programe të tilla nuk zbatohen qartësisht politikën e integritit të romëve, por mund të kenë lidhje të dukshme ose potencialisht jo të drejtëpërdrejta me zbatimin e politikës së integritit të komunitetit rom (siç reflektohet edhe në titullin e tyre). Programet që nuk lidhen drejtëpërdrejtë me integrimin zakonisht i dedikohen popullatës së gjerë ose grupeve vulnerabël apo grupeve të pakicave. Nëse ka dyshime nëse programi nuk lidhet ose lidhet në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë me integrimin e komunitetit rom, atëherë këshillohet që një program i tillë të klasifikohet si program me numrin '2'. Kjo do të bëjë që ky program të analizohet edhe më tej (përmes hapave të mëposhtëm).

Kategoria 0. Programi **nuk lidhet** me integrimin e komunitetit rom. Sipas titullit të programit buxhetor, nuk duket se ka marrëdhënie me integrimin e romëve.

Klasifikimi duhet të fillojë me nivelet më të ulëta të programimit (nga nivelet më të ulëta të zberthimit të programit buxhetor duke shkuar drejt programeve buxhetore). Nivelet më të larta të programimit duhet të klasifikohen duke iu hedhur një sy niveleve më të ulëta të tyre dhe duhet të vendosen në kategorinë më të lartë sipas lidhjes që kanë me këtë politikë në nivelet më të ulëta.

Hapi i parë në buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom është klasifikimi i çdo programi buxhetor sipas lidhjes që ka ai me integrimin e komunitetit rom.

Kjo shërben për të identifikuar programet buxhetore që mund të kontribuojnë në zbatimin e politikës për integrimin e këtij komuniteti.

Shembulli praktik për hapin 1

Tabela e mëposhtme është një pjesë e nxjerrë nga një buxhet publik hipotetik për Ministrinë e Arsimit si një përdorues i buxhetit (i shënuar me numrin 24 në shembull). Ai përmban shpërndarjen e buxhetit sipas programeve (të shënuar me numrin 24.x) dhe produkteve/nënprogrameve (të shënuar me një numër me 4 shifra). Kolona e fundit nuk është në buxhetin aktual, por është shtuar tek shembulli për të treguar klasifikimin e mundshëm të programeve buxhetore në hapin e parë të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom.

| | Programi/ nënprogrami | Aktiviteti/Projekti | Buxheti | |
|------|---|---|-------------|---|
| 24 | MINISTRIA E ARSIMIT | | 143,150,613 | |
| 24 | MINISTRIA E ARSIMIT – I PËRGJITHSHËM | | 2,568,439 | 2 |
| 201 | Zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë | | 1,857,572 | 0 |
| | | Mbështetje për realizimin e interesave të përgjithshëm në novacion | 100,002 | 0 |
| | | Administrimi dhe qeverisja | 103,048 | 0 |
| | | Mbështetja e IPA-s për anëtarësim në programe | 1,654,522 | 0 |
| 2001 | Qeverisja, monitorimi dhe zhvillimi i të gjitha niveleve të arsimit | | 710,867 | 2 |
| | | Përgatitja e legjislacionit për të gjitha nivelet e arsimit | 259,379 | 2 |
| | | Inspektimi i punës në të gjitha objektet arsimore | 58,122 | 2 |
| | | Administrimi dhe qeverisja | 218,967 | 0 |
| | | Përparimi i cilësisë në arsim | 53,420 | 2 |
| | | Rritja e mundësisë së pjesëmarrjes në arsim, parandalimi i braktisjes dhe i diskriminimit | 25,007 | 2 |
| | | Përgatitja e kuadrit të kualifikimit | 3,000 | 2 |
| | | Mbështetja për projektet me interes në arsim | 10,000 | 2 |
| | | IPA 2014 – Mbështetje e sektorit për punësimin e të rinjve dhe përfshirjen e tyre aktive | 57,843 | 2 |
| | | IPA 2013 – Mbështetje për integrimin evropian dhe projektet zhvillimore për vitet 2014–2020 | 25,129 | 2 |
| 24.1 | ARSIMI BAZË | | 72,090,351 | 2 |
| 2002 | Arsimi parashkollor | | 2,200,000 | 2 |
| | | Mbështetje për realizimin e programit të arsimit parashkollor prej katër orësh | 2,200,000 | 2 |
| 2003 | Arsimi bazë | | 69,890,351 | 2 |
| | | Realizimi i arsimit bazë | 67,087,013 | 2 |
| | | Konkurset e nxënësve (arsimi bazë) | 7,500 | 0 |
| | | Modernizimi i infrastrukturës së shkollave në arsimin bazë | 2,162,944 | 0 |

| | Programi/ nënprogrami | Aktiviteti/Projekti | Buxheti | |
|------|---|---|------------|---|
| | | Pajisja me materiale mësimore për nxënësit, të të regjistruarve të rinj dhe objekteve shkollore | 632,894 | 2 |
| 24.2 | ARSIMI I MESËM | | 33,437,603 | 1 |
| 2004 | Arsimi i mesëm | | 33,437,603 | 1 |
| | | Realizimi i arsimit të mesëm | 31,658,348 | 2 |
| | | Puna me nxënësit e talentuar | 15,000 | 0 |
| | | Modernizimi i infrastrukturës së shkollave në arsimin e mesëm | 1,240,130 | 0 |
| | | Bursa për nxënësit romë në arsimin e mesëm | 514,125 | 1 |
| | | Reforma në arsimin e mesëm | 10,000 | 0 |
| 24.3 | STANDARDET E NXËNËSVE (arsimi para-universitar) | | 3,896,976 | 2 |
| 2007 | Mbështetje për nxënësit në arsim | | 3,896,976 | 2 |
| | | Sistemi i standardeve në objektet shkollore | 3,169,854 | 0 |
| | | Mbështetje individuale për nxënësit | 727,122 | 2 |
| 24.4 | ARSIMI I LARTË | | 23,881,420 | 2 |
| 2005 | Arsimi universitar | | 23,881,420 | 2 |
| | | Mbështetje për punën e universitetit në qytetin X | 17,575,735 | 0 |
| | | Mbështetje për punën e universitetit në qytetin Y | 5,840,485 | 0 |
| | | Mbështetje për hapjen e universiteteve | 214,000 | 2 |
| | | Mbështetje për realizimin e studimeve pasuniversitare | 200,000 | 0 |
| | | Zhvillimi i arsimit të lartë | 51,200 | 0 |
| 24.5 | STANDARDET E STUDENTËVE (universiteti) | | 7,031,464 | 2 |
| 2007 | Mbështetje për studentët në arsim | | 7,031,464 | 2 |
| | | Sistemi i standardeve në mjediset e studentëve | 5,173,664 | 2 |
| | | Mbështetje individuale për studentët | 1,857,800 | 2 |
| 24.6 | INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT | | 142,068 | 2 |
| 2001 | Qeverisja, monitorimi dhe zhvillimi i të gjitha niveleve të arsimit | | 142,068 | 1 |
| | | Rishikimi i teksteve shkollore për të hequr prej tyre paragjykimet ndaj romëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të tjerëve | 127,008 | 1 |
| | | Arsimi profesional dhe i të rriturve | 4,870 | 2 |
| | | Zhvillimi profesional i mësuesve | 10,190 | 2 |
| 24.7 | INSTITUTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË NË ARSIM | | 102,292 | 2 |
| 2001 | Qeverisja, monitorimi dhe zhvillimi i të gjitha niveleve të arsimit | | 102,292 | 2 |
| | | Sigurimi i cilësisë në sistemin arsimor | 93,034 | 2 |
| | | Mbështetje me ekspertë në mjediset shkollore për vlerësimin dhe vetë-vlerësimin | 9,258 | 0 |

Më poshtë jepet shpjegimi i klasifikimit të programeve buxhetore specifike të paraqitura në shembullin e mësipërm.

- ✳ **Përgatitja e legjislacionit për të gjitha nivelet e arsimit:** Ky program nuk është drejtpërdrejt i lidhur me integrimin e romëve. Në këtë rast, politika për integrimin e romëve (Strategjia dhe Plani i Veprimit) duhet të rishikohen për të propozuar ndërhyrje legjislative në fushën e arsimit. Nëse propozime të tilla nuk ekzistojnë, atëherë programi buxhetor duhet të klasifikohet si kategoria '0'. Një shembull i ngjashëm gjendet tek programi buxhetor Modernizimi i infrastrukturës së shkollave në arsimin bazë. Në këtë rast, nëse politika për integrimin e romëve parashikon, për shembull, rinovimin e një shkolle në një vendbanim të romëve, atëherë programi duhet të jetë kategoria '2'.
- ✳ **Rritja e mundësisë së pjesëmarrjes në arsim, parandalimi i braktisjes dhe i diskriminimit:** Ky program është një shembull i një programi të lidhur indirekt me romët (sepse ai i referohet të gjithë popullsisë) dhe kështu klasifikohet si '2'. Për shkak se braktisja dhe diskriminimi përbëjnë dy çështje me rëndësi themelore për arsimimin e romëve, ato ndikojnë drejtpërdrejt tek zbatimi i politikës së integritit të romëve.
- ✳ **Përgatitja e kuadrit të kualifikimit:** Meqë kuadri i kualifikimit përcakton sistemin e profesioneve, ky program buxhetor ka lidhje me një numër fushash të integritit të romëve ku janë parashikuar edhe llojet e ndërmjetësuesve romë (të tillë si në fushën e shëndetësisë, mbrojtjes sociale, etj.) përveç fushës së arsimit.
- ✳ **Bursa për nxënësit romë në arsimin e mesëm:** Ky është një shembull i një programi buxhetor që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e politikës për integrimin e romëve sepse politika parashikon bursa për nxënësit romë të arsimit të mesëm. Programi buxhetor synon posaçërisht romët.
- ✳ **Mbështetja për hapjen e universiteteve:** Ky është një shembull i një programi buxhetor me një titull të paqartë. Ai nuk ofron informacion të mjaftueshëm se kujt i referohet dhe si i tillë mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Përfshirja e më shumë romëve në arsimin e lartë është parashikuar në pjesën më të madhe të politikave për integrimin e komunitetit rom. Nëse "hapje" e universiteteve interpretohet si hapje ndaj përfshirjes së më shumë studentëve, atëherë programi buxhetor do të lidhej qartë indirekt me politikën për integrimin e romëve dhe duhet të klasifikohet si kategoria '2'. Kërkohej një analizë e mëtejshme për të përcaktuar nëse është i saktë klasifikimi i këtij programi buxhetor.
- ✳ **Rishikimi i teksteve shkollore për të hequr prej tyre paragjykimet ndaj romëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të tjerëve:** Ky është një shembull i një programi buxhetor që lidhet drejtpërdrejt me integrimin e romëve, që në mënyrë të qartë synon të trajtojë edhe romët mes grupeve të tjera vulnerabël të tillë si grupet me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera të pakicave.

Gjatë fazës së pilotimit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, është e këshillueshme të klasifikohet buxheti i alokuar për ministrinë e linjës përgjegjëse për fushat prioritare në politikën për integrimin e romëve (arsim, punësim, shëndetësi, strehim, etj.). Po ashtu, gjatë pilotimit ose fazës tjetër të zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët mund të klasifikohen edhe pjesë të tjera të buxhetit që mund të lidhen me çështje ndërsektorale të integritit të romëve, të tilla si mosdiskriminimi, ulja e varfërisë, regjistrimi civil dhe barazia gjinore. Synimi duhet të jetë të klasifikohet gradualisht i gjithë buxheti.

2. Analiza e përputhshmërisë së përmbajtjes së programeve

Hapat nga dy deri në pesë analizojnë çdo program të veçantë buxhetor. Në fazën e pilotimit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, mund të analizohen vetëm 1 deri në 2 programe buxhetore, mundësisht nga Kategoritë 1 dhe 2. Gradualisht, analiza duhet të përfshijë të gjitha programet buxhetore nga të gjitha kategoritë. Analiza e secilit program buxhetor duhet të bëhet më e lehtë me kalimin e kohës, sepse programet zakonisht mbeten të njëjtat. Megjithatë, programet buxhetore mund të ndryshojnë në aspektin e klasifikimit dhe përmbajtjes së tyre, siç do të analizohen me hapat e ardhshëm. Këto ndryshime duhet të merren parasysh kur të shfaqen.

Hapi i dytë i buxhetimit të përgjegjshëm për romët analizon programin buxhetor dhe politikën e integritit të romëve, duke krahasuar objektivat, treguesit dhe aktivitetet e tyre.

Ai shërben për të identifikuar nivelin e sinkronizimit që do të ndihmojë procesin e buxhetimit.

Për të kryer hapin e dytë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, është me rëndësi të kuptohet qasja e kornizës logjike (korniza logjike). Kjo qasje përdoret kur planifikohen ndërhyrje, qoftë një program, nënprogram, masë, projekt apo ndërhyrje të një natyre të ngjashme. Qasja në fjalë përqendrohet tek rezultatet e pritshme si dhe tek mënyra se si maten rezultatet. Korniza logjike përdoret gjithashtu për të paraqitur një ndërhyrje në një rrjedhë logjike përmes një matrice që ofron një pasqyrë të saktë të të gjithë ndërhyrjes së planifikuar.

Pjesa kryesore e qasjes së kornizës logjike është hierarkia e objektivave ose zinxhiri i rezultateve. Kjo pjesë tregon logjikën me të cilën inputet e ndërhyrjes transformohen në ndikimin që ajo ka në situatën e përgjithshme që duhet të ndryshohet. Kjo logjikë mund të paraqitet thjesht përmes ilustrimit të mëposhtëm.



- ✳ Inputet janë të gjitha burimet e investuara në një ndërhyrje, dhe ato mund të jenë financiare, njerëzore, materiale ose të ndonjë forme tjetër.
- ✳ Agjentët zbatues ndërmarrin një veprim duke përdorur burimet.

- ✳ Veprimi prodhon produkte (outputet) konkrete të cilat mund të jetë në formën e mallrave të prodhuara, shërbimeve të ofruara, dokumenteve të miratuara ose rezultate të ngjashme. Produktet (outputet) janë mjete për të prodhuar rezultate dhe nuk janë në vetvete qëllimi i ndërhyrjes.
- ✳ Rezultatet, objektivat specifike dhe ndikimi janë ndryshimet aktuale që ndodhin në fushën në të cilën kryhet ndërhyrja. Ato ndryshojnë sipas nivelit.
- ✳ Rezultatet janë ndryshime të prodhuara drejtpërsëdrejti nga ndërhyrja dhe janë tërësisht nën kontrollin e ndërhyrjes.
- ✳ Objektivat specifike lidhen me ndryshimet e drejtpërsëdrejta si pasojë e ndërhyrjes, por këto mund të ndikohen nga faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndërhyrjen.
- ✳ Ndikimi është ndryshimi më i madh, indirekt që prodhohet nga ndërhyrja ose ndryshimi në të cilin kontribuon ndërhyrja sëbashku me një sërë ndërhyrjesh të tjera dhe faktorëve të tjerë të jashtëm.
- ✳ Rezultatet, objektivat specifike dhe ndikimi përbëjnë hierarkinë e objektivave ose zinxhirin e rezultateve.

Terminologjia e përdorur për të përshkruar qasjen e kornizës logjike mund të ndryshojë, siç tregohet në tabelën e mëposhtme.

| koncepti | Termet e ndryshëm të përdorur |
|---------------------|---|
| Veprime | Masa. Projekte, aktivitete |
| Outpute | Produkte |
| Rezultate | Produkte, produkte të menjëhershme, produkte të ndërmjetme |
| Objektiva specifike | Qëllime, synime, objektiva, outcome |
| Ndikimi | Qëllimi strategjik, synimi strategjik, objektivi i përgjithshëm |

Treguesit përkatës dhe vlerat e treguesve shoqërojnë secilin objektivi në hierarkinë e objektivave në kornizën logjike. Me anë të treguesëve arrihet të matet suksesi i arritjes së objektivit (ose niveli në të cilin është plotësuar objektivi). Ndonjëherë ata quhen edhe 'tregues të verifikueshëm objektivisht' për shkak të nevojës për të identifikuar në fakt vlerën e tyre në kohë dhe vlerat të regjistruhen dhe të vihen në dispozicion. Matrica të caktuara të kornizës logjike kërkojnë burimet (mjetet) e verifikimit, që në fakt janë agjentët aktualë (institucioni, personi) që kryejnë matjen sipas treguesve dhe prodhojnë (publikojnë) vlerat e tyre përgjatë kohës. Vlerat e një treguesi ndryshojnë me kalimin e kohës. Në fillim të çdo ndërhyrjeje, vlera e treguesit quhet 'vlera bazë' ose 'pika e fillimit'. Nga kjo pikë fillon ndërhyrja për të ndryshuar një situatë të dhënë dhe nga kjo pikë duhet të ndryshojë edhe vlera e treguesit. Vlera e treguesit duhet të matet përgjatë një periudhe, veçanërisht gjatë kryerjes së ndërhyrjes. Vlera e treguesit në një kohë të caktuar është 'vlera aktuale'. Zakonisht, vlerat e treguesit maten periodikisht. Vlera e dëshiruar e treguesit që pritet të arrihet pas zbatimit të ndërhyrjes është 'synimi'.

Korniza logjike mund të përfshijë supozime ose faktorë dhe rreziqe që lidhen me realizimin e ndërhyrjes dhe arritjen e çdo objektivit në zinxhirin e rezultateve. Për buxhetimin e përgjegjshëm për romët, kjo pjesë e kornizës logjike nuk është në fokus të analizës.

Matrica e kornizës logjike, siç përdoret nga Bashkimi Europian, tregohet më poshtë.

| Qinshiri i rezultateve | Treguesi | Vlera bazë | Vlera aktuale | Vlera e synuar | Burimi dhe mjetet e verifikimit | Supozime | Ndikimi (objektivi i përgjithshëm) | Outcome (s) (objektivi(at) specifik) |
|--|---|-----------------------|--|--|--|---|---|---|
| Ndryshimi më i madh afat-gjatë në të cilin kontribuon veprimi në ekonomi, në nivel rajoni ose sektori në fushën politike, shoqërore, ekonomike dhe mjedisore në kontekstin global që do të vijë nga ndërhijet e ndërmarra nga të gjithë aktorët dhe palët e interesuara përkatëse. | Variabli sasior dhe/ose cilësor që ofron një mjet të thjeshtë dhe të besueshëm për të matur arritjen e rezultatit korrespondues. Kur është e mundur, treguesi të paraqitet i ndarë sipas gjinisë, moshës, qytet/fshat, aftësisë së kufizuar, etj. | (njëlloj si më sipër) | Vlera e treguesit (ve) përpara ndërhijes përkundrejt të cilët mund të vlerësohet ose krahasohet niveli i përparimit. | Vlera më e fundit në dispozicion e treguesit (ve) në kohën e raportimit. | Vlera e synuar finale e treguesit (ve). Burimet e informacionit dhe metodat e përdorura për të mbledhur dhe raportuar mbi vlerat e treguesit (ve), përfshirë kush, kur, dhe sa shpesh mbledhet informacioni. | Nuk zbatohet në këtë rast | Ndikimi (objektivi i përgjithshëm) | Outcome (s) (objektivi(at) specifik) |
| Efekti afatmesëm i ndërhijes, duke u përqendruar tek ndryshimet e sjelljes dhe institucionale që rezultojnë nga ndërhijja (zakonisht një, ose më shumë për veprime më të mëdha) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | Faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të projektit që mund të ndikojnë tek ndikimi/rezultati (tet). | Faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të projektit që mund të ndikojnë tek ndikimi/rezultati (tet). | Faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të projektit që mund të ndikojnë tek ndikimi/rezultati (tet). |

| Qinshiri i rezultateve | Treguesi | Vlera bazë | Vlera aktuale | Vlera e synuar | Burimi dhe mjetet e verifikimit | Supozime | *Outcome të tjera (*ku mund të ketë) (ketë) | Rezultate | Matrica e aktivitetit |
|---|--|-----------------------|-----------------------|-----------------------|---------------------------------|--|---|-----------|-----------------------|
| Kur ka efekte të tjera afatshkurtra të ndërhijes duke u përqendruar tek ndryshimet e sjelljes dhe institucionale që rezultojnë nga ndërhijja (p.sh. rezultatet e menjëhershme mund të futen këtu). | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | Faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të projektit që mund të ndikojnë tek objektivi specifik/ outcome të tjera. | *Outcome të tjera (*ku mund të ketë) (ketë) | Rezultate | Matrica e aktivitetit |
| Produkte të drejtpërdrejta/ të prekshme (infrastruktura, mallrat dhe shërbimet) të dhëna/të prodhuara nga ndërhijja. (*Në parim, outputet duhet të lidhen me outputet korresponduese përmes vendosjes së qartë të numrave). | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | Faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të projektit që mund të ndikojnë tek outputet. | *Outcome të tjera (*ku mund të ketë) (ketë) | Rezultate | Matrica e aktivitetit |
| Cilat janë aktivitetet kryesore për t'u realizuar me qëllim që të prodhohen outputet e synuara? (*Në parim, aktivitetet duhet të lidhen me outputet korresponduese përmes vendosjes së qartë të numrave). | Mjetet Cilat janë burimet politike, teknike, financiare, njerëzore dhe materiale që kërkohen për kryejn e këtyre aktiviteteve, p.sh. personeli, pajisjet, furnizimet, ambientet operacionale, etj. Kostot Cilat janë kostot e veprimt? Si klasifikohen ato? (Ndarja në buxhet për Veprimin) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | (njëlloj si më sipër) | Faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të projektit që mund të ndikojnë tek aktivitetet / lidhjet e outputeve. | *Outcome të tjera (*ku mund të ketë) (ketë) | Rezultate | Matrica e aktivitetit |

Hapi i dytë i buxhetimit të përgjegjshëm për romët është të krahasojë dhe përcaktojë shkallën në të cilën sinkronizohen programi buxhetor dhe politika për integrimin e romëve kur bëhet fjalë për objektivat e tyre në zinxhirin e rezultateve, treguesit dhe vlerat e tyre (vlera bazë, aktuale dhe e synuar) dhe aktivitetet e tyre. Për kryerjen e këtij hapi, është e nevojshme të rishikohen dokumentet e politikave përkatëse që i korrespondojnë programit buxhetor të analizuar dhe mundësisht të punohet me personat përgjegjës për atë program.

Një krahasim midis hierarkisë së objektivave të programit buxhetor dhe politikës për integrimin e romëve duhet të bëhet në lidhje me përmbajtjen e tyre. Në këtë kuptim, konceptet dhe idetë kryesore të objektivave (të shprehur përmes fjalëve kyçe dhe shprehjeve të përdorura) duhet të përcaktohen dhe të krahasohen për të gjetur ngjashmëritë. Krahasimi duhet të rezultojë në rekomandime mbi sinkronizimin e objektivave të programit buxhetor dhe të politikës për integrimin e romëve.

Treguesit (për secilin prej objektivave në zinxhirin e rezultateve) duhet të analizohen për emërtimin dhe përkufizimin e tyre. Emërtimet mund të ndryshojnë, dhe thelbi i treguesve mund të jetë i njëjtë. Njëkohësisht, emërtimet mund të jenë të njëjta, dhe metoda e përlogaritjes ose vlerat e inputit të përdorur për llogaritjen e treguesve mund të ndryshojnë. Më poshtë jepen shembuj.

Krahasimi i aktiviteteve është një procedurë relativisht e lehtë, meqë aktivitetet zakonisht renditen dhe përshkruhen, ato rrallë mund të jenë të paqarta. Megjithatë aktivitetet shpesh nuk janë të formuluar në të njëjtën mënyrë, ngjashmëritë janë zakonisht të dukshme. Nëse ka ndonjë pasiguri për natyrën e një aktiviteti, atëherë duhet të kërkohet informacion shtesë nga zyrtarët dhe nëpunësit publikë përgjegjës për programin buxhetor dhe ndoshta edhe për vetë aktivitetet konkrete.

Nisur nga shembulli i përdorur në hapin e parë, programi buxhetor: 'Realizimi i arsimit bazë' është përzgjedhur për të ilustruar hapin e dytë të buxhetimit të përgjegjshëm të romëve. Shembulli është hipotetik dhe objektivat, treguesit dhe veprimet janë formuluar për të ilustruar hapin e dytë në buxhetimin e përgjegjshëm të romëve.

| | Programi buxhetor | Politika për integrimin e komunitetit rom | Hapi 2 Analiza |
|-----------------------------|---|--|--|
| Titulli | Realizimi i arsimit bazë | Strategjia Kombëtare për Integrimin e Romëve – Plani i Veprimit për Arsimin – kapitulli për arsimin bazë | Nuk zbatohet |
| Objektivi strategjik | 1) Rritja e cilësisë së procesit dhe e rezultateve të arsimit në nivelin më të lartë të arritshëm: buron nga njohuritë shkencore në arsim dhe praktikata e reja në arsim. 2) Rritja e mbulimit për të gjithë popullsinë në të gjitha nivelet e arsimit, nga arsimit parashkollor deri tek të nxënësve | Garantimi i përfshirjes së plotë të fëmijëve dhe të rinjve të komunitetit rom në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm cilësor, përfshirja më e madhe e burave dhe grave romë tek popullata e studentëve dhe sigurimi i mbështetjes për | Nga identifikimi i fjalëve kyçe tek të dy objektivat, mund të arrihet në përfundimin se objektivat lidhen si më poshtë: 1. Arsimit cilësor sigurohet për të gjithë / përfshirë romët. 2. Mbulimi më i gjerë i të gjithëve /përfshirë romët në arsim në të gjitha nivelet. 3. Arsimit është i rëndësishëm për zbatimin e të drejtave të pakicave për romët në arsim. |

| | Programi buxhetor | Politika për integrimin e komunitetit rom | Hapi 2 Analiza |
|-----------------------------|--|--|---|
| Objektivi strategjik | gjatë të gjithë jetës. 3) Arritja dhe ruajtja e rëndësisë së arsimit, veçanërisht e formave të arsimit të financuara plotësisht apo pjesërisht përmes burimeve publike, duke harmonizuar strukturën e sistemit arsimor me nevojat e menjëhershme dhe zhvillimore të individëve , ekonomike, shoqërore, kulturore, studimore, publike, administrative dhe sistemet e tjera. 4) Rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve për arsim: përfundimi i arsimit në kohë, me një zgjatje minimale dhe me një ulje të përqindjes së braktisjes . | arsimimin e të rinjve dhe të rriturve që nuk kanë ndjekur shkollën ose e kanë braktisur , së bashku me futjen e mekanizmave efektiv dhe efikas për të luftuar diskriminimin dhe krijimi i kushteve në të cilat romët mund të ushtrojnë të gjitha të drejtat e pakicës në sistemin arsimor. | 4. Efikasiteti në arsim është rritur, në kuptimin që arsimin në maksimum duke përdorur burime minimale (me ulje të braktisjes dhe rritje të ndjekjes së shkollës). Dy objektivat ndryshojnë në aspektet e mëposhtme: 1. Një rritje e outcomes në arsim është parashikuar për popullsinë në përgjithësi, por jo për politikën për integrimin e romëve. 2. Vëmendje e veçantë i jepet riintegrit të personave që nuk ndjekin ose e braktisin shkollën në politikën për integrimin e romëve, por jo në politikën e përgjithshme. 3. Politika për integrimin e romëve parashikon luftën kundër diskriminimit, por politika e përgjithshme nuk e përmend në mënyrë të qartë atë (megjithatë pjesa e arsimit duhet të përfshinte dispozita kundër diskriminimit). Përveç rekomandimit për sinkronizimin më të mirë të objektivave strategjikë të të dyja politikave (të përgjithshmes dhe integrit të romëve), këshillohet të përmirësohet formulimi i objektivave (duke përdorur ato S.M.A.R.T.). |
| Treguesi | Nuk janë parashikuar tregues për të matur ndikimin (objektivi/qëllimi strategjik). | Nuk janë parashikuar tregues për të matur ndikimin (objektivi/qëllimi strategjik). | Megjithatë në asnjë prej politikave nuk ka tregues për ndikimin, rekomandohet përcaktimi i treguesve të tillë që të jenë të sinkronizuar për të dyja politikat. Përmes identifikimit të koncepteve kyçe në objektivat strategjikë, mund të arrihet në përfundimin se treguesit duhet të përgatiten për të matur: cilësinë, mbulimin (p.sh. përqindjet e regjistrimit dhe të kalueshmërisë), marrëdhënien, efikasitetin (p.sh. përqindja e braktisjes), diskriminimin (p.sh. incidenca e diskriminimit). Po ashtu, duhet të rekomandohet që treguesit të lejojnë për ndarjen e të dhënave sipas gjinisë dhe etnisë. Për më tepër, pas përgatitjes së treguesve, duhet të identifikohen edhe vlerat bazë, vlerat aktuale dhe ato të synuara. |
| Objektivi specifik | Deri në vitin 2020, të gjithë fëmijët në moshë shkollimi, siç parashikohet në ligj (minimumi 98% e çdo gjenerate), pavarësisht nga karakteristikat e tyre social-ekonomike, kombëtare, gjuhësore, etnike, fetare dhe të tjera, përfshihen në arsimin bazë cilësor , me një braktisje më të ulët se 5% (p.sh. 93% e çdo gjenerate përfundon arsimin bazë) në nivel kombëtar, përfshirë fëmijët nga grupet vulnerabël (në zonat rurale, romët, të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, dhe të tjerë). | Sigurori arsim bazë dhe të mesëm të mirë dhe cilësor për fëmijët dhe të rinjtë romë. Parandaloni braktisjen e shkollës dhe sigurori forma të tjera shtesë për përkrahje deri në përfundimin e arsimit të mesëm. | Objektivat specifike të të dyja politikave janë në përgjithësi në përputhje. Të dyja i referohen cilësisë në arsim, parandalimit të braktisjes dhe përfundimit të shkollimit. Megjithatë, objektivi tek politika e përgjithshme nuk e përmend qartë përkrahjen dhe mbështetjen shtesë për romët ose grupet vulnerabël. Po ashtu, politika për integrimin e romëve nuk e përmban qartë regjistrimin e dëshiruar dhe nivelet e përfundimit. Këto përfshihen tek objektivi në politikën e përgjithshme dhe janë në fakt synime të politikës. Të njëjtat synime duhet të zbatohen edhe për fëmijët romë. |

| | Programi buxhetor | Politika për integrimin e komunitetit rom | Hapi 2 Analiza |
|-------------------------|--|--|---|
| Treguesit | Nuk janë formuluar tregues specifikë vetëm për objektivin specifik. Përqindja e regjistrimit Përqindja e braktisjes Përqindja e përfundimit (të ndara sipas gjinisë, zonës, etnisë, aftësisë së kufizuar) | Përqindja neto e futjes në shkollë Përqindja neto e ndjekjes së shkollës Përqindja e përfundimit Indeksi i barazisë gjinore | Politika e përgjithshme nuk përmban tregues të posaçëm. Treguesit mund të identifikohen nga formulimi i vetë objektivit. Politika për integrimin e romëve parashikon tregues të qartë. |
| Baza e referimit | Përqindja e regjistrimit: 95% ose 97%. Përqindja e kalueshmërisë: 98% (përqindja e braktisjes nga ata që janë të regjistruar është 2%). Përqindja e përfundimit: 95% (për ata që ndjekin klasën e fundit të shkollës). | Përqindja e regjistrimit: 78% ose 69.1%. Përqindja e kalueshmërisë: 85%. Përqindja e përfundimit: 64%. | Edhe politika për popullsinë në përgjithësi, edhe politika për integrimin e romëve ofrojnë të dhëna të caktuara referimi për treguesit për të dyja, për popullsinë në përgjithësi dhe për romët. Megjithatë, vlerat e ofruara janë të ndryshme. Për përqindjen e regjistrimit, politika e përgjithshme vë në dukje se 95% e të gjithë popullsisë regjistrohet në arsimin bazë, ndërsa politika për integrimin e romëve parashikon se 97% e popullsisë së përgjithshme regjistrohet në arsimin bazë. Njëkohësisht, politika e përgjithshme pohon se 78% e komunitetit rom regjistrohet në arsimin bazë, ndërsa politika për integrimin e romëve thekson se 69.1% e romëve regjistrohen në arsimin bazë. Në strategjinë e përgjithshme jepet përqindja e kalueshmërisë, ndërsa përqindja e braktisjes të përlogarit nga përqindja e kalueshmërisë, por vetëm për popullsinë në përgjithësi. Përqindja e kalueshmërisë për romët jepet vetëm në politikën për integrimin e romëve, por aty nuk ofrohet krahasimi me të gjithë popullsinë. Përqindja e përfundimit të shkollimit jepet në mënyrë të ngjashme si përqindja e kalueshmërisë, me një shënim që politika për popullsinë në përgjithësi monitoron përqindjen e përfundimit më shumë për ata që ndjekin vitin e fundit të nivelit arsimor sesa për të gjithë në gjeneratën korresponduese. Rekomandohet që vlerat referuese të sinkronizohen dhe të përdoren të njëjtat burime, metodologji dhe vite. |
| Synimet | Përqindja e regjistrimit: 99%. Përqindja e braktisjes: 5%. Përqindja e përfundimit: 93%. | Synimet nuk janë përfshirë në politikën për integrimin e romëve. | As politika për popullsinë e përgjithshme, as politika për integrimin e romëve nuk përmbajnë synime të qarta. Megjithatë, objektivat për popullsinë e përgjithshme përfshihen në politikën e përgjithshme si pjesë e objektivit specifik. Në këtë rast, politika për integrimin e romëve nuk përmban ndonjë objektiv. Rekomandimi nga kjo analizë është të përcaktohen synime për popullsinë rome dhe të sinkronizohen synimet për popullsinë e përgjithshme dhe popullsinë rome në të dyja politikatat. |

Analiza e rezultateve, përfshirë treguesit dhe vlerat e treguesve për rezultatet, kryhet në mënyrë të ngjashme me analizën e objektivit strategjik. Nga analiza duhet të nxirren rekomandimet përkatëse.

| | Programi buxhetor | Politika për integrimin e komunitetit rom | Hapi 2 Analiza |
|--------------------|--|--|---|
| Aktivitetet | <ul style="list-style-type: none"> ⦿ Përgatitja e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit. ⦿ Ndërtimi i 5 shkollave të reja. ⦿ Përfshirja e fëmijëve romë në aktivitete jashtëshkollore. ⦿ Rishikimi i kurrikulës së arsimit bazë. ⦿ Zhvillimi i mekanizmit për përzgjedhjen e lëndëve me zgjedhje nga vetë nxënësit. ⦿ Analiza e teksteve shkollore për të identifikuar ndonjë mangësi në lidhje me barazinë gjinore, multikulturalizmin, respektimin e diversitetit dhe vlerave demokratike. ⦿ Zbatimi i modelit për identifikimin e individëve që kanë detyrimin të përfundojnë arsimimin e tyre. | <ul style="list-style-type: none"> ⦿ Angazhimi i mësuesve ndihmës. ⦿ Ndihmë juridike dhe administrative për regjistrimin. ⦿ Trajnimi i mësuesve për gjithpërfshirjen. ⦿ Seminare për vajzat rome për kalimin nga klasa e katërt në klasën e pestë. ⦿ Transporti në shkollë për fëmijët (në largësi për më shumë se 3 kilometra). ⦿ Identifikimi i fëmijëve romë në rrezik për të braktisur shkollën. | <p>Krahasimi midis aktiviteteve të parashikuara në programin buxhetor dhe në politikën për integrimin e romëve korrespondojnë në një shkallë të caktuar. Politika e përgjithshme, për shembull, parashikon zbatimin e një modeli për identifikimin e individëve të detyruar për të përfunduar shkollimin e tyre që mund t'i korrespondojë identifikimit të fëmijëve romë në rrezik për braktisjen e shkollës. Po ashtu, ajo përfshin pjesëmarrjen e fëmijëve romë në aktivitete jashtëshkollore (që nuk është parashikuar tek politika për integrimin e romëve, por është e rëndësishme për realizimin e qëllimeve të saj). Në mënyrë të ngjashme, ajo përmban aktivitete të tjera që mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e politikës për integrimin e romëve. Nga ana tjetër, politika e integritit të romëve përmban një sërë masash që nuk janë parashikuar në programin buxhetor, të tilla si transporti i fëmijëve, ndihma juridike dhe administrative për regjistrimin, trajnimi i mësuesve, etj.</p> <p>Rekomandimi nga kjo analizë është të sinkronizohen masat në të dyja politikatat dhe në veçanti të përfshihen masat e parashikuara në politikën për integrimin e romëve tek programi buxhetor.</p> |

Rekomandimet që dalin nga analiza e hierarkisë së objektivave, treguesve (dhe vlerat të tyre) dhe aktiviteteve duhet të jenë sa më konkrete. Rekomandimet e paraqitura tek shembulli janë të një natyre të përgjithshme. Rekomandimet konkrete duhet të përpunojnë saktësisht se si duhet të sinkronizohen politikatat, duke përfshirë formulimin e propozuar, formulimin e treguesve me përkufizimet e tyre, propozimet për burime konkrete informacioni, etj.

Më tej, rekomandimet mund të japin sugjerime për ndryshime në programin buxhetor, në politikën për integrimin e romëve ose për të dyja. Ndërsa udhëzimet përqëndrohen në analizimin dhe propozimin e ndërhyrjeve të dobishme për ta bërë buxhetin më të përgjegjshëm ndaj integritit të romëve. Analiza mund të zbulojë mangësi në politikën e hartuar, si në programin buxhetor ashtu edhe në politikën për integrimin e romëve. Analiza lidhet vetëm me buxhetin, sepse qëllimi i buxhetit është të arrijë objektivat dhe synimet e dëshiruara. Prandaj, analiza në hapin e dytë, mund të sjellë përfundime mbi domosdoshmërinë për të rishikuar objektivat dhe treguesit ose aktiviteteve e secilës politikë. Në këtë kuptim, mund të vërtetohet që objektivat janë ose shumë ambiciozë, ose jo ambiciozë sa duhet, që treguesit janë ose nuk janë mjaftueshmërisht të saktë për të matur rezultatet, që nuk ekzistojnë sistemet për prodhimin e të dhënave me mundësinë për t'i ndarë ato sipas gjinisë apo kombësisë për të informuar për arritjen e objektivave dhe rrjedhimisht për efektivitetin e buxhetit të shpenzuar ose që aktiviteteve e secilës nga politikatat duhet të përmirësohen me qëllim arritjen e objektivave të vendosura.

Në këtë kuptim, gjatë analizës në hapin e dytë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët duhet të formulohen rekomandime të përshtatshme. Për më tepër, hapi i dytë ndihmon edhe në identifikimin e pikave strategjike për ndërhyrje dhe vendimmarrësit të cilët duhet të kenë informacion për mundësitë për përmirësim. Kjo do të sigurojë që fondet shpenzohen më mirë dhe se në terren po ndodhin ndryshime reale, si për romët ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi.

Siç mund të tregojë eksperiencia, herë pas herë mund të mos jetë e mundur të realizohet përputhje e suksesshme për shkak të mosdetajimit dhe mosndarjes të dokumenteve politike / ose buxheteve. Kjo çështje do të zgjidhet me kalimin e kohës, ndërsa reforma e buxhetimit të programit ecën përpara. Megjithatë, edhe në një rast të tillë, ky hap tregon qartë papajtueshmëritë dhe nevojën për ndarjen dhe sinkronizimin e mëtejshëm të degëve të politikave dhe buxhetit. Në këtë kuptim, hapi i dytë i buxhetimit të përgjegjshëm për romët ofron informacion të dobishëm që mund të ndihmojë vendimmarrësit mbi politikën dhe modifikimet buxhetore.

Siç shihet nga shembulli i dhënë, informacioni i nevojshëm për analizën e buxhetit të përgjegjshëm për romët mund të mos jetë gjithnjë i disponueshëm (politikën mund të mos kenë tregues, objektivat mund të mos jenë të përcaktuara qartë, aktivitetet mund të jenë të interpretueshme etj.). Për të kuptuar dhe mbledhur informacion që nevojitet duhet bashkëpunim i ngushtë me zyrtarët dhe nëpunësit publikë përgjegjës për analizën e programit buxhetor.

Idealisht, analiza e kryer gjatë hapit të dytë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët duhet të informojë në ç'masë kontribuojnë objektivat e politikës së integritit të romëve tek objektivat e programit buxhetor dhe anasjelltas. Përlllogaritja është e mundur nëse informacioni për objektivat dhe treguesit (me vlerat për bazën dhe synimet) është i disponueshëm dhe i sinkronizuar (në kuptim të formulimit/përkufizimit dhe burimeve të të dhënave). Në rast se treguesit janë të shprehur si përqindje, për llogaritjen janë gjithashtu të nevojshëm edhe numrat absolutë. Përlllogaritja mund të bëhet vetëm nëse afatet kohore të të dyja politikave (duke përfshirë afatet kohore të vlerave bazë dhe atyre të synuara) janë të njëjta.

Shembull

| | Programi buxhetor | Politika për integrimin e romëve |
|---|---|---|
| Objektivi | Rritja e regjistrimit të fëmijëve në arsimin bazë. | Rritja e regjistrimit të fëmijëve romë në arsimin bazë. |
| Treguesi | Përqindja e regjistrimit | Përqindja e regjistrimit |
| Baza | 95% | 78% |
| Synimi | 98% | 90% |
| Vlerat absolute | Të gjithë fëmijët: 350,000 Të regjistruar 95%: 332,500 Synimi 98%: 343,000 Diferenca: 10,500 | Fëmijët romë: 7,500 Të regjistruar 78%: 5,850 Synimi 90%: 6,750 Diferenca: 900 |
| Kontributi i objektivit për romët në objektivin e programit buxhetor: 900/10,500 ose (shprehur në përqindje): 8.6%. | | |

Ka 350,000 fëmijë në këtë shembull hipotetik, përfshirë 7,500 fëmijë romë në moshë të përshtatshme për regjistrim në shkollë. Vlera absolute e fëmijëve aktualisht të regjistruar në arsim mund të jepet ose përlllogaritet nëse ofrohet vlera bazë e treguesit. Në shembullin e mësipërm, 332,500 fëmijë, përfshirë 5,850 fëmijë romë regjistrohen në arsim. Për arritjen e synimeve të përcaktuara, 10,500 fëmijë më shumë duhet të regjistrohen sipas programit buxhetor dhe 900 fëmijë romë më shumë duhet të regjistrohen për të arritur objektivin e politikës për integrimin e romëve. Kjo do të thotë se nëse arrihet objektivi i politikës për integrimin e romëve, ai do të përbëjë 8.6% të realizimit të objektivit të programit buxhetor. Kjo përlllogaritje është e vlefshme për një fazë të mëvonshme kur të kryhet analiza e buxhetit dhe të formulohen rekomandimet për të siguruar që buxheti është në përputhje me kërkesat e romëve.

Ndërkohë që analiza tek hapi i dytë është kryesisht analizë cilësore, në kuptimin që krahason përmbajtjen e programit buxhetor dhe politikën për integrimin e romëve, detyra e fundit në hapin e dytë është një analizë sasiore që mund të sjellë pasoja financiare. Kjo analizë sasiore prodhon informacionin e nevojshëm për të bërë propozime sasiore për buxhetin, shërben si një argument për të përshtatur buxhetin dhe përfaqëson një urë lidhëse drejt hapit të tretë dhe qendror të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin rom përmes të cilit analizohen alokimet aktuale të buxhetit. Informacioni mbi kontributin sasiore të politikës për integrimin e romëve tek objektivat, më e rëndësishmja, ndikimi tek programi buxhetor, duhet të përdoret për të formuluar gjykime dhe marrë vendime në lidhje me buxhetin aktual.

3. Analiza e buxhetit

Hapi i tretë i buxhetimit të përgjegjshëm për romët është një analizë komplekse e buxhetit aktual brenda programit buxhetor. Nga kjo analizë duhet të dalin disa përfundime mbi:

- ✳ Buxhetin e alokuar për politikën e integritit të romëve në programin buxhetor të analizuar;
- ✳ Përputhshmërinë e pjesës së buxhetit për integrimin e romëve me buxhetin e planifikuar në dokumentet e politikës për integrimin e romëve (dhe rrjedhimisht me objektivat e politikës për integrimin e romëve);
- ✳ Përputhshmërinë e pjesës së buxhetit për integrimin e romëve me objektivat e përgjithshëm të programit buxhetor të analizuar, sipas kontributit të objektivave të integritit të romëve tek objektivat e programit buxhetor.

Analiza gjatë hapit të tretë do të sigurojë informacion nëse janë alokuar sa duhet inpute financiare për të mbështetur objektivat e politikës për integrimin e romëve në mënyrë të vazhdueshme.

Për të kryer këtë analizë është e nevojshme të ketë informacion mbi çështjet e mëposhtme:

- a. **shpenzimet e planifikuara për politikën e integritit të romëve** (zakonisht gjenden tek dokumenti i Strategjisë ose i Planit të Veprimit). Preferohet që shpenzimet t'i korrespondojnë periudhës kohore të buxhetit publik;

- b. informacion sasior mbi përqindjen e objektivit të integritit të romëve krahasuar me objektivin e programit buxhetor të analizuar**, siç përlogaritet ose vlerësohet si detyrë finale e hapit të dytë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët (Në shembullin më sipër, regjistrimi i 900 fëmijëve romë në arsimin bazë, siç parashikohet tek objektivi për integrimin e romëve, përfaqëson 8.6% kontribut në arritjen e objektivit të programit buxhetor);
- c. shpenzimet e alokuara aktualisht për objektivin e programit buxhetor që i korrespondon objektivit të integritit të romëve** si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të alokuara në programin buxhetor të analizuar, të ndarë me zëra në buxhet;
- d. shpenzimet e alokuara aktualisht për zbatimin e politikës për integrimin e romëve** në programin buxhetor të analizuar si pjesë e alokimit për objektivin korrespondues tek programi buxhetor.

Një analizë e buxhetit për programin buxhetor të Kategorisë 1, i lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e politikës për integrimin e romëve ka të ngjarë të jetë më e lehtë sesa për një program buxhetor të Kategorisë 2, siç klasifikohen në hapin e parë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët. Programet buxhetore të klasifikuara si Kategoria 1 mund të jenë programe buxhetore që kanë të bëjnë ose shumë qartë dhe vetëm me zbatimin e politikës për integrimin e romëve, ose shumë qartë por jo vetëm me zbatimin e politikës për integrimin e romëve. Në rastin e parë, i gjithë buxheti i alokuar në programin buxhetor është në fakt për zbatimin e politikës për integrimin e romëve dhe prandaj analiza duhet të përqendrohet vetëm tek përputhshmëria e tij me buxhetin e planifikuar në dokumentet mbi politikën e integritit të romëve. Në rastin e dytë, kërkohet një analizë e plotë e buxhetit me qëllim që të identifikohet pjesa e buxhetit të marrë nga programi buxhetor që është alokuar për zbatimin e politikës për integrimin e romëve, siç do të ishte rasti për çdo program buxhetor të Kategorisë 2.

Në terma praktikë, për të kryer hapin e tretë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët duhet të shihet buxheti i programit buxhetor të ndarë sipas zërave dhe buxheti i planifikuar në dokumentet mbi politikën e integritit të romëve (Strategjia ose Plani i Veprimt). Në rast se periudhat kohore të dy buxheteve nuk përputhen, atëherë duhet të kryhen përlogaritje ose parashikime për të identifikuar buxhetin për vitet buxhetore korresponduese për të dyja, edhe për programin buxhetor, edhe për politikën për integrimin e romëve.

Hapi i tretë i buxhetimit të përgjegjshëm për romët është një analizë komplekse e buxhetit tek programi buxhetor, i parë nga perspektiva e zbatimit të kërkesave të politikës për integrimin e romëve.

Ky hap është pjesa qendrore e procesit, që sjell si rrjedhojë një numër përfundimesh dhe rekomandimesh për buxhetin.

Tabela e mëposhtme paraqet një shembull hipotetik të të dy buxheteve. Programi buxhetor është i ndarë sipas shpenzimeve dhe politika për integrimin e romëve sipas aktiviteteve. Shembulli në këtë hap mbështetet tek shembulli i përdorur në hapin e mëparshëm, përmes të cilave u zbulua se kontributi i objektivit të politikës për integrimin e romëve tek objektivi korrespondues në programin buxhetor për regjistrimin e fëmijëve në arsimin bazë ishte 900 fëmijë romë ose 8.6% e totalit prej 10,500 fëmijë.

| | Programi buxhetor – Arsimi bazë | Politika për integrimin e romëve – Arsimi bazë | |
|-------------------------|--|---|--|
| Aktivitetet | Identifikoni fëmijët e moshës së duhur Dërgoni letrën e regjistrimit tek prindërit Ofroni asistencë sociale për prindërit në nevojë Ndërtoni pesë shkolla të reja | Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve Ndihmë juridike për marrjen e dokumenteve civile Identifikoni fëmijët e moshës së duhur | Aktivitetet |
| Zërat e buxhetit | 111 Pagat e punonjësve 28,000,200 112 Kontributet shoqërore 7,800,000 113 Kontribute jomonetare 300,000 114 Dietat 1,700,000 115 Shpërblimet për punonjësit 350,000 116 Shpenzimet për mirëmbajtje 7,000,000 117 Shpenzimet e udhëtimit 3,500,000 118 Pagesa për kontratë shërbimi 35,000,000 119 Shërbime të posaçme 4,560,000 120 Taksat 200,000 150 Makineri dhe pajisje 500,000 TOTALI 88,910,200 | Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve 10,000 Ndihmë juridike për marrjen e dokumenteve civile 10,000 Identifikoni fëmijët e moshës së duhur 5,000 TOTALI 25,000 | Masat e politikës për integrimin e romëve dhe buxheti i alokuar (tek Plani i Veprimt) |

Tabela më sipër krahason programin buxhetor të arsimit bazë me pjesën që lidhet me arsimin bazë tek politika për integrimin e romëve (Shembulli është i supozuar dhe i thjeshtuar për të bërë të mundur një kuptim dhe analizë më të mirë). Masat e nxjerra nga politika për integrimin e romëve ndikojnë në objektivin e programit buxhetor për rritjen e regjistrimit në arsimin bazë në përgjithësi. Megjithatë, alokimet e zërave të buxhetit të përfshira në programin buxhetor nuk ndihmojnë të kuptohet më lehtë se në cilat aktivitete konkrete ndikojnë ato. Në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët dhe nëpunësit civilë përgjegjës për programin buxhetor, analiza e ngjashme me atë të përshkruar më poshtë duhet të japë informacionin e nevojshëm për vendosjen e lidhjes midis politikës për integrimin e romëve dhe buxhetit.

Analiza e dy buxheteve, plani i buxhetit për programin buxhetor dhe plani i buxhetit nga dokumenti i politikës për integrimin e romëve (Strategjia përkatëse apo Plani i Veprimit të saj), përbëhet nga detyrat e mëposhtme

- 1. Identifikimi i zërave të buxhetit brenda programit buxhetor përmes të cilit mund të zbatohen veprimet e planifikuara në kuadër të politikës për integrimin e romëve si pjesë e zbatimit të programit buxhetor.** Praktikisht, kjo do të thotë që për secilin aktivitet/masë të planifikuar në kuadrin e politikës për integrimin e romëve duhet të identifikohet një zë buxhetor përmes të cilit mund të financohet aktiviteti. Duke qënë se zërat e linjave buxhetore nuk janë vetë-shpjeguese, kjo analizë duhet të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me punonjësit ose nëpunësit publikë përgjegjës për buxhetin e programit të buxhetuar. Ata duhet të jenë të aftë të japin informacion mbi kostot aktuale (të mundshme) të mbuluara nga secili prej zërave të buxhetit.

Tre skenarë janë të mundshëm të financimit të aktiviteteve të politikës për integrimin e romëve:

- është planifikuar si pjesë e një zëri të veçantë të buxhetit brenda programit buxhetor.
- nuk është planifikuar si pjesë e një zëri të veçantë të buxhetit brenda programit buxhetor por ka elemente të përshtatshëm në buxhet përmes të cilave mund të ndiqet financimi i aktiviteteve të integrimin të romëve.
- nuk është planifikuar si pjesë e ndonjë zëri të buxhetit dhe nuk ka zëra të përshtatshëm të buxhetit përmes të cilave mund të financohen aktivitetet e politikës për integrimin e romëve.

Në rastin e skenarit të dytë, një nga rekomandimet lidhur me buxhetin duhet të jetë për caktimin e një pjese të veçantë të zërit të përshtatshëm në buxhet për kryerjen e aktiviteteve për integrimin e romëve në shumën e duhur. Në skenarin e tretë, rekomandimi lidhur me buxhetin duhet të përfshijë një zë buxhetor shtesë përmes të cilit të financoheshin me shumën e duhur aktivitetet për integrimin e romëve.

Sidoqoftë, për identifikimin e shumës së duhur që i korrespondon planeve për politikën e integrimin të romëve dhe kontributin e saj në objektivat e programit buxhetor, duhet të përcaktohen objektiva.

- 2. Konstatimi i pjesës së shpenzimeve të identifikuara të buxhetit brenda programit buxhetor të caktuar për politikën e përgjithshme që i korrespondon politikës së integrimin të romëve.** Çdo program buxhetor përmban një buxhet që shpërndahet në një sërë objektivash dhe aktiviteteve të programit buxhetor si dhe shpenzime të tjera (të tilla si kostot operationale). Përmes këtij hapi të analizës, duhet të identifikohet, llogaritet ose vlerësohet buxheti aktual i caktuar për zbatimin e objektivit të programit buxhetor që korrespondon me objektivin për integrimin e romëve. Detyra duhet të realizohet në bashkëpunim me personat përkatës që punojnë për programin buxhetor, zë për

zëri. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zërave përkatës për zbatimin e politikës së integrimin të romëve të identifikuar përmes detyrës së parë të analizës buxhetore të përshkruar më sipër.

- 3. Konstatimi i shpërndarjes së shpenzimeve për politikën e integrimin të romëve brenda zërit të programit buxhetor; llogaritja e pjesës (përqindjes) së shumës specifike në buxhet për politikën e integrimin të romëve brenda programit buxhetor; krahasimi i pjesës specifike për politikën e integrimin të romëve të identifikuar në kuadër të programit buxhetor me buxhetin e planifikuar për aktivitetin përkatës në planin për integrimin e romëve.**

Kjo do të thotë se nga alokimet buxhetore nga secila linjë buxhetore e planifikuar për realizimin e objektivit të programit buxhetor që korrespondon me objektivin e integrimin të romëve, pjesa konkrete e planifikuar ose që mund të planifikohet për të zbatuar aktivitetet e integrimin të romëve duhet të identifikohet, llogaritet ose vlerësohet. Pastaj duhet të krahasohet me buxhetin e planifikuar në kuadër të dokumentave politik për integrimin e romëve.

Sërish, ka disa skenarë të mundshëm në lidhje me atë pjesë të buxhetit brenda linjës përkatëse buxhetore të planifikuar për realizimin e aktiviteteve për integrimin e romëve:

- Nuk ka asnjë buxhet të planifikuar për realizimin e aktiviteteve për integrimin e romëve si pjesë e zërit buxhetor të përshtatshëm për financimin e këtyre aktiviteteve.
- Ka buxhet por jo me shumën e nevojshme siç është planifikuar në dokumentat e politikave të integrimin të romëve.
- Ka buxhet me një shumë që korrespondon saktësisht me shumën e planifikuar në dokumentat e politikave të integrimin të romëve.
- Ka buxhet me një shumë që tejkalon buxhetin e planifikuar në dokumentat politikë të integrimin të romëve.

Me përjashtim të rastit të skenarit të tretë, të gjithë skenarët e tjerë kërkojnë ndërhyrje buxhetore qoftë në programin buxhetor, qoftë në planet e politikave për integrimin e romëve si në drejtim të rritjes apo dhe të uljes së pjesës së planifikuar për politikën e integrimin të romëve brenda programit buxhetor apo dhe për të përshtatur planet në politikën për integrimin e romëve. Rekomandimet duhet të formulohen në përputhje me gjetjet.

- 4. Krahasimi i përqindjes të shpenzimeve të akorduara për politikën e integrimin të romëve me përqindjen me të cilën objektivi për integrimin e romëve kontribuon në objektivin e politikës së përgjithshme.** Kjo detyrë përfundimtare e analizës së buxhetit duhet të ofrojë informacion mbi mjaftueshmërinë e alokimeve buxhetore për zbatimin e politikës për integrimin e romëve brenda programit buxhetor të analizuar të parë nga perspektiva e arritjes së objektivit të politikës së integrimin të romëve, dhe

kështu për kontributin e tij në arritjen e objektivit të programit buxhetor. Natyrisht, nëse akordimi është i pamjaftueshëm, atëherë duhet të formulohet një rekomandim konkret për akordimet buxhetore të diskutuara dhe të dakortësuara me zyrtarët ose nëpunësit publikë përgjegjës për programin buxhetor. Duhet të vihet në dukje se edhe në rastin e alokimeve në masën e duhur në buxhet nga aspekti i kontributit për objektivin e integritit të romëve në objektivin e programit buxhetor të përgjithshëm, akordimi i buxhetit ende mund të jetë i pamjaftueshëm për të arritur objektivin e programit buxhetor ose objektivin për integrimin e romëve. Kjo duhet të krijohet brenda hapit të katërt të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, ku analizohet zbatimi konkret i buxhetit përkundrejt efikasitetit dhe dobishmërisë së tij në përmbushjen e objektivave të programit.

Pas analizimit të shembullit (tabelës) të dhënë më sipër dhe pas konsultimit me ministrinë e linjës dhe Ministrinë e Financave, u vendos që:

- ✳ Një pjesë e fondeve në masën 500,000 tek zëri 'Pagesat për kontratën e shërbimit' u parashikuan për aktivitetin 'Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve'. Nga kjo shumë, 7,000 është planifikuar për kryerjen e aktivitetit korrespondues të planifikuar në kuadër të politikës për integrimin e romëve që në planin e politikës për integrimin e romëve është buxhetuar me 10,000.
- ✳ Një pjesë e fondeve në masën 20,000 tek zëri 'Shërbime të posaçme' i kalojnë fondeve për aktivitetin 'Identifikoni fëmijët e moshës së duhur', por asnjë prej burimeve nuk është alokuar në mënyrë të qartë për aktivitetin korrespondues tek politika për integrimin e romëve.
- ✳ Fonde nuk janë parashikuar në buxhet për aktivitetin 'Ndihmë juridike për të marrë dokumentet civile', megjithëse një shumë prej 10,000 të paparashikuara në ndonjë fushë specifike janë rezervuar për shpenzimet aktuale që mund të kryhen, sipas zërit tek shpenzimet.

Gjetjet mund të paraqiten si më poshtë:

| Politika për integrimin e romëve | | Zërat e programit buxhetor | | | | |
|---|--|---|-----------------------|---|--|--------------|
| Aktiviteti | Buxheti i planifikuar (tek dokumentet mbi politikën për integrimin e romëve) | Zëri i buxhetit tek programi buxhetor | Buxheti i planifikuar | Pjesa e caktuar për objektivin e përgjithshëm të programit buxhetor në lidhje me rritjen e regjistrimit në arsimin bazë | Pjesa e caktuar aktualisht për aktivitetin korrespondues të integritit të romëve | |
| | | | | | Sasia | Përqindja |
| Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve | 10,000 | Pagesat e kontratës së shërbimit | 35,000,000 | 500,000 | 7,000 | 1.4% |
| Identifikoni fëmijët e moshës së duhur | 5,000 | Shërbime të posaçme | 4,560,000 | 20,000 | 0 | / |
| Ndihmë juridike për të marrë dokumentet civile | 10,000 | Kontributet jomonetare | 300,000 | 0 (10,000 mund të alokohet) | 0 (2,000 mund të alokohet) | 20% |
| Totali | 25,000 | | 39,560,000 | 520,000 | 7,000 | 1.34% |

Në lidhje me aktivitetin e parë "Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve", 10,000 është planifikuar tek dokumentet e politikës për integrimin e romëve, ndërsa në buxhetin aktual kjo shumë është 7,000. Prandaj, minimalisht, pjesa tek buxheti aktual duhet të rritet që t'i korrespondojë planit për integrimin e romëve. Po ashtu, pjesa e buxhetit aktual për politikën për integrimin e romëve brenda këtij zëri të buxhetit është vetëm 1.4 për qind (7,000 nga numri i përgjithshëm prej 500,000). Objektivi i lidhur me romët kontribuon tek objektivi korrespondues tek programi buxhetor me 8.6% dhe prandaj duhet të rekomandohet që të rritet pjesa e caktuar për zbatimin e kësaj mase të integritit të romëve. Qëllimi është që të përshtatet kjo përqindje me numrin 43,000 nga i gjithë zëri i buxhetit i caktuar për objektivin korrespondues te programi buxhetor prej 500,000. Rrjedhimisht, rekomandimet për ndryshimet në buxhet janë edhe për dokumentin e politikës për integrimin e romëve, edhe për buxhetin e programit buxhetor të analizuar.

Në lidhje me aktivitetin "Identifikoni fëmijët e moshës së duhur" nuk ka në buxhet fonde të parashikuara për objektivin e integritit të romëve. Pa dyshim, rekomandimi duhet të jetë që të pasqyrohen fondet e planifikuara në politikën për integrimin e romëve tek programi buxhetor. Megjithatë, nëse numri prej 5.000 i planifikuar tek politika për integrimin e romëve është marrë nga zëri korrespondues në buxhet prej 20.000, atëherë pjesa për zbatimin e politikës për integrimin e romëve do të ishte 25%, që nuk është në përputhje me përqindjen e kontributit të përcaktuar të objektivit për integrimin e romëve në objektivin e programit buxhetor të përgjithshëm prej 8.6%. Përsëri, rekomandimi do të ishte të përshtatet njëri ose të dy buxhetet (politika për integrimin e romëve dhe programi buxhetor) për të reflektuar përqindjen tek objektivat. Nëse rekomandimi ka të bëjë me buxhetin e planifikuar tek politika për integrimin

e romëve, atëhere rekomandimi është të zvogëlohet numri në 1,720 (ose 8.6% e 20,000). Nëse rekomandimi përdoret për buxhetin e planifikuar në programin buxhetor, atëhere rekomandimi është të rritet numri në 58,140 (ku 5,000 e planifikuar tek politika për integrimin e romëve do t'i korrespondonte 8.6%). Nëse rekomandimi është të përshtaten të dyja buxhetet, atëhere shifrat konkrete duhet të propozohen duke marrë në konsideratë përqindjen prej 8.6% të parashikuar tek politika për integrimin e romëve në zërin e programit buxhetor.

Në rastin e aktivitetit 'Ndihmë juridike për të marrë dokumentet civile', nuk janë parashikuar fare fonde, as për objektivin e përgjithshëm të programit buxhetor, as për objektivin për integrimin e romëve. Megjithatë, pas diskutimeve me punonjësit dhe nëpunësit civilë përgjegjës mundet që ata të vënë në dukje se është e mundur të parashikohen 10,000 (për të përgjithshmin) dhe 2,000 (për objektivin për integrimin e romëve). Ndërsa alokimet nuk pasqyrojnë përqindjen e kontributit të objektivit të integritit të romëve në objektivin e programit të përgjithshëm buxhetor, rekomandimi mund të ishte ruajtja e alokimeve të mundshme siç janë identifikuar dhe të përshtaten gradualisht sasi të ciklet buxhetorë të ardhshëm mbi bazën e shpenzimeve aktuale dhe arritjeve të bëra drejt realizimit të objektivave të integritit të romëve dhe të programit buxhetor si rezultat i aktiviteteve të kryera duke përdorur buxhetin e përcaktuar.

Shembulli i përdorur për të ilustruar analizën e buxhetit të kryer në hapin e tretë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët shërben vetëm për të shpjeguar procesin nga ana praktike. Nuk shqyrtohen të gjithë skenarët e mundshëm që mund të ndodhin në realitet, sepse ata janë të shumtë. Personat që kryejnë buxhetimin e përgjegjshëm për romët duhet të jenë të hapur për shumë mundësi që mund të ketë dhe duhet të kenë aftësitë analitike për nxjerrjen e përfundimeve të përshtatshme dhe formulimin e rekomandimeve të duhura mbi bazën e situatës aktuale. Është shumë e këshillueshme që analiza të kryhet dhe përfundimet e rekomandimit të përgatiten në bashkëpunim të ngushtë me personat përgjegjës për buxhetin dhe zbatimin e programeve buxhetore. Qëllimi është rritja e sasisë së informacionit të mbledhur, identifikimi i mundësive të arritshme dhe realiste dhe ndihma për përgatitjen e rekomandimeve të pranueshme dhe të arsyeshme për buxhetin.

Megjithatë, edhe kur ka bashkëpunim të ngushtë me personat përgjegjës për programin buxhetor, mund të mos jetë e mundur të merret informacioni i kërkuar për të kryer analizën, veçanërisht për sasinë e fondeve dhe zërave të linjave buxhetore përmes të cilave financohen aktivitete të caktuara. Në këtë rast, duhet të shpjegohet rëndësia e politikës për integrimin e romëve dhe duhet të propozohen zgjidhje për të gjetur një mënyrë për alokimin në buxhet të fondeve për zbatimin e politikës për integrimin e romëve. Kjo duhet të bëhet sa më konkrete të jetë e mundur me qëllim përmirësimin e procesit në ciklet pasardhëse të buxhetimit të përgjegjshëm për romët.

Kur realizohet ky hap i buxhetimit të përgjegjshëm për romët, siç u përmend më parë, është e rëndësishme të marrin pjesë ministratë e linjës dhe Ministria e Financave dhe zyrtarë dhe nëpunës të tjerë publikë. Ndërkohë që linjat buxhetore që i korrespondojnë një programi të caktuar buxhetor ofrojnë pak informacion rreth ndarjes së shpenzimeve (klasifikimi ekonomik –

për pagat, shpenzimet administrative dhe të tjera të ngjashme), ato rrallë tregojnë shpërndarjet buxhetore për ndërhyrje konkrete në politikën (p.sh. rritja e regjistrimit në arsimin bazë). Për të marrë më shumë informacion të thelluar rreth programit buxhetor korrespondues, është e nevojshme të diskutohet me personelin përkatës për të analizuar programin buxhetor dhe politikën për integrimin e romëve nga perspektiva e buxhetit.

Është propozuar edhe më sipër tek udhëzimet, se personat që realizojnë buxhetimin e përgjegjshëm për romët duhet të kuptojnë ciklin e buxhetit, siç parashikohet dhe siç zbatohet në praktikë. Hapi i tretë në këtë proces shërben për të siguruar një kuptim më të mirë të këtyre çështjeve. Po ashtu, ai shërben për të identifikuar pikat kryesore strategjike (procedurat dhe palët e interesuara me ndikim). Mbi bazën e këtij kuptimi, do të bëhet e mundur të jepen rekomandime të realizueshme në hapin e pestë.

4. Vlerësimi i ekzekutimit të buxhetit

Tri hapat e mëparshëm të buxhetimit të përgjegjshëm për romët i referohen procesit të planifikimit. Me këto hapa, krijohen lidhje sa më të mira të mundshme ndërmjet politikës për integrimin e romëve dhe asaj të përgjithshme si dhe me programin përkatës buxhetor. Planet për të dyja politikën janë analizuar gjatë fazës së hartimit të tyre dhe rekomandimet e nxjerra u referohen planeve, duke përfshirë buxhetin të planifikuar, për vitin ose periudhën në vijim.

Hapi i katërt vlerëson zbatimin e buxhetit dhe si kontribuon ai në arritjen e objektivave të integritit të romëve dhe programit të analizuar të buxhetit. Vlerësimi shërben për të vendosur marrëdhënie ndërmjet inputeve buxhetore dhe outputeve dhe rezultateve të politikave. Kjo do të thotë se buxheti i planifikuar (për të cilin kontribuojnë tre hapat e parë) monitorohet tanimë gjatë ekzekutimit të tij për të vlerësuar performancën përkatëse.

Me kalimin e viteve, mund të vërehen tendencat e ndryshimeve në buxhet dhe kjo mund të ndihmojë në nxjerrjen e përfundimeve përkatëse dhe në propozimin e ndryshimeve të duhura në buxhet.

Mbështetur në vlerësimin e zbatimit të buxhetit dhe rezultatet e arritura përmes këtij zbatimi, mund të bëhen propozime në lidhje me planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit (për ciklet e buxhetit aktual ose të ardhshëm), si dhe për strukturën e duhur të burimeve dhe të shumave të planifikuara dhe të shpenzuara.

Hapi i katërt vlerëson realizimin e buxhetit për integrimin e romëve dhe kontributin e tij në arritjen e objektivave të përcaktuara, si për politikën e integritit të romëve dhe për programin buxhetor.

Informacioni i marrë, përfshirë informacionin mbi shfaqjen e tendencave me kalimin e kohës, bëhet më pas pjesë e procesit të planifikimit për buxhetin e vitit të ardhshëm, duke rritur kështu përgjegjshmërinë e buxhetit për integrimin e romëve.

Me pak fjalë, hapi i katërt do të vlerësojë nëse inputet ekzistuese dhe rezultatet përkatëse kontribuojnë në rezultatin e dëshiruar. Është e mundur të përcaktohen skenarë të ndryshëm në lidhje me saktësinë e planifikimit, realizimit dhe ndikimit të buxhetit, megjithatë analiza duhet t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme me qëllim që të formulojë përfundime dhe rekomandime.

❖ A po zbatohet buxheti sipas planit? Nëse nuk ndodh kështu, ka mbishpenzime apo nënshpenzime? A është mbishpenzimi/nënshpenzimi i vazhdueshëm dhe nëse po, deri në çfarë pike?

Për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve është e nevojshme të merret informacion mbi aktivitetet/masat e zbatuara, mbi përfituesit, të ndarë sipas gjinisë dhe etnisë; shpenzimet aktuale, shpërndarjen e shpenzimeve për të gjitha zërat e buxhetit siç janë raportuar; rishikimet eventuale të buxhetit dhe ri-ndarjet nëpër linjat buxhetore. Në rast se informacioni nuk është i disponueshëm, duhet të sigurohet informacion i nevojshëm. Bazuar në informacionin dhe pas analizës së procesit të buxhetit me hollësi, duhet të nxirren një sërë konkluzionesh lidhur me shumën e buxhetit, përthithjen, luhatjet etj. Me qëllim që veprimtaritë/masat e planifikuara të zbatohen plotësisht, është veçanërisht e rëndësishme të bëhen shqyrtime të dhura të buxhetit lidhur me mjaftueshmërinë e tij, pra të shihet nevoja për ta rritur ose për ta ulur atë. Mbishpenzimi ose nënshpenzimi i buxhetit janë gjithashtu të rëndësishme, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një situatë të përsëritur. Arsyet që çojnë si në mbishpenzim por edhe në nënshpenzim duhet të hulumtohen sa më mirë për të formuluar rekomandimet përkatëse, qofshin këto për ndryshime në ndarjet buxhetore (ulje/rritje), për përmirësimin e kapaciteteve përthithëse, përshtatjen dhe përmirësimin e rregulloreve dhe praktikave për zbatimin e buxhetit (përfshirë regjistrimin e të dhënave mbi realizimin e buxhetit), për përshtatjen dhe përmirësimin e zbatimit të aktiviteteve ose rregullimin dhe përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe regjistrimin e rezultateve të aktiviteteve (veçanërisht për përfituesit).

❖ A kontribuon buxheti në mënyrë të drejtpërdrejtë si tek objektivat e politikës për integrimin e Romëve ashtu dhe tek programi përkatës i buxhetit të përgjithshëm?

Buxheti i planifikuar duhet të krahasohet me buxhetin e zbatuar realisht në mënyrë që të vlerësohet nëse ka devijime në drejtim të planifikimit, kontrollit dhe zbatimit të buxhetit. Gjithashtu, duhet të vërtetohet/përcaktohet më mirë niveli në të cilin zbatimi i buxhetit kontribuon për objektivat e përcaktuara në politikën për integrimin e romëve dhe në programin buxhetor. Përveç informacionit mbi përfituesit, si romë ashtu edhe të tjerë, kërkohet të jepet përgjigje nëse aktivitetet/masat e kryera prodhojnë drejtpërdrejtë ndryshimet e parashikuara, e thënë ndryshe, nëse alokimet financiare po i shërbejnë qëllimit apo jo, nëse politika është hartuar mirë dhe nëse ka mangësi në zbatim. Nëse aktivitetet/masat e planifikuara të financuara nga buxheti i përcaktuar nuk po sjellin rezultatet e pritshme, atëherë ekziston nevoja për rishikimin e politikave,

veçanërisht në lidhje me përfshirjen dhe/ose prioritizimin e aktiviteteve/masave që do të sillnin faktikisht rezultatet e dëshiruara. Informacioni mund të tregojë, për shembull, se aktivitetet e financuara nga buxheti kontribuojnë në arritjen e objektivave të programit buxhetor, por kontribuojnë aspak ose pak në arritjen e objektivave përkatëse të integritit të romëve. Kjo në fakt do të thotë se ato janë duke kufizuar arritjen e objektivit të programit buxhetor dhe po bëjnë që integrimi i romëve të mbetet prapa. Prandaj, ky skenar do të kërkonte shumë më tepër përpjekje për të ekuilibruar situatën në të ardhmen. Një tjetër skenar i mundshëm mund të jetë që aktivitetet e kryera të financuara nga buxheti japin rezultate vetëm gjatë kohëzgjatjes së aktiviteteve, por nuk sjellin ndryshime të qëndrueshme. Të gjitha përfundimet e nxjerra nga analiza e informacionit të mbledhur duhet të përkthehen në rekomandime të përshtatshme për të përmirësuar hartimin e politikave, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e tyre.

❖ Si ka ndikuar (pozitivisht apo negativisht) shpenzimi i buxhetit tek objektivat e planifikuara?

Kjo pyetje kërkon informacion mbi ndikimin e politikave, të matura sipas të dhënave të përgjithshme statistikore (siç janë të dhënat për nivelin e punësimit, nivelin e përfundimit të arsimit, rrezikun e nivelit të të pastrehëve, normën e mbulimit me sigurime shëndetësore etj.). Me kalimin e kohës është shumë e rëndësishme të mblidhen të dhëna statistikore periodikisht dhe këto të dhëna statistikore të ndahen sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike. Ky lloj informacioni i shërben orientimit strategjik, pasi vë në dukje angazhimet e përgjithshme strategjike, si në kuadër të politikës për integrimin e romëve dhe të programit të buxhetit të përgjithshëm, krahasuar me objektivat e përcaktuara strategjike. Analiza mund të japë përfundime dhe rekomandime përkatëse sipas objektivave strategjike, si psh. domosdoshmëria për t'i bërë masat më realiste ose për të përcaktuar synime më të larta, apo lidhur me përshtatshmërinë e shpenzimeve për arritjen e objektivave të përcaktuara strategjike. Më tej, analiza e orientimit strategjik mund të nxjerrë në pah nevojën për të zhvendosur vetë orientimin strategjik për t'u përgjigjur situatës gjithnjë në ndryshim dhe faktorëve të jashtëm (siç janë legjislacioni i ri, etj.) që ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në rezultatet e tyre.

❖ Kur krahasohen dy cikle të njëpasnjëshme buxhetore, a korrespondojnë siç duhet prirjet për ndarjen e buxhetit me përthithjen e buxhetit dhe me ndryshimet e vazhguara në terren përgjatë gjithë kohës?

Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje është e nevojshme të krahasohen buxhetet e të paktën dy viteve me qëllim që të përcaktohen tendencat e shpenzimeve: pra, nëse pjesa në buxhet ulet apo rritet me kalimin e kohës dhe nëse trendi është i përputhshëm me rezultatet e arritura nëpërmjet shpenzimeve të mëparshme. Edhe pse janë bërë shkurtime në buxhet, edhe pse arritet nuk janë të mjaftueshme për të siguruar ndryshime afatgjata, apo edhe pse gjendja në terren është prapa, është e mundur të konstatohet se buxhetet janë rritur megjithëse ka fakte se politika përkatëse nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë tek

situata e vëzhguar, se shpërndarjet buxhetore janë rritur pavarësisht nga mungesa e vazhdueshme e absorbimit të fondeve etj. Krahasimi i tendencave në alokimet dhe shpenzimet buxhetore me arritjet duhet të japin informacion nëse buxheti duhet të rritet apo të ulet në ciklet e tij të ardhshme (aktualisht të planifikuara).

Për të kryer vlerësimin në hapin e katërt të buxhetimit të përgjegjshëm për romët duhet të ekzistojë një sistem i zhvilluar mirë monitorimi që të mbledhë gjithë informacionin e nevojshëm. Procesi i monitorimit duhet të jetë i vazhdueshëm për të bërë të mundur mbikëqyrjen e zbatimit të burimeve financiare të planifikuara në një vit dhe për të propozuar ndërhyrje kur është e nevojshme. Sistemi duhet të japë informacion mbi numrin e përfituesve nga komuniteti Romë dhe përfituesve të përgjithshëm (të ndarë sipas gjinisë) si dhe të dhëna statistikore të nevojshme për të matur efektin e arritur. Kjo kërkon futjen e sistemeve të grumbullimit të të dhënave të ndara. Në të vërtetë, një pjesë e informacionit nuk do të jetë i disponueshëm dhe prandaj do të jetë e nevojshme të kryhen vlerësime ose të sigurohen modele bazuar në informacionin ekzistues dhe të gatshëm të disponueshëm (si nga burimet zyrtare ashtu edhe nga burime të tjera) duke përllogaritur vlerësimet më të mira të mundshme sipas informacionit ekzistues. Me kalimin e kohës, sistemet e grumbullimit të të dhënave, monitorimit dhe raportimit duhet të përparojnë siç duhet dhe të jenë në gjendje të ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm. Si i tillë, ky informacion jo vetëm që do t'i shërbejë buxhetimit të përgjegjshëm për romët, por do të përmirësojë në të vërtetë performancën e përgjithshme të qeverisë lidhur me prioritetet e saj strategjike.

Ministria e Financave ka një pasqyrë shumë të mirë të rezultateve që sjellin ministrinë e tjera të veçanta dhe di se sa mirë ato i planifikojnë dhe përthithin burimet. Prandaj, ajo duhet të përfshihet në procesin e buxhetimit të përgjegjshëm për romët në mënyrë që të sigurojë informacionin e nevojshëm mbi buxhetin. Agjencitë statistikore duhet të angazhohen gjithashtu për të siguruar që informacioni i nevojshëm për arritjen e objektivave të politikave të mblidhet dhe të vihet në dispozicion. Natyrisht, ministrinë e linjës përgjegjëse për programet e buxhetit dhe njësitë/organet qeveritare përgjegjëse për integrimin e romëve janë aktorët kryesorë në këtë proces. Buxheti publik zakonisht është i decentralizuar dhe prandaj pushteti vendor duhet të përfshihet për të ofruar informacion. Në mënyrë të ngjashme, me kalimin e kohës duhet të përfshihen aktorë joqeveritarë që kanë informacionin përkatës për situatën në terren dhe ndikimin (ndryshimet) e sjellë përmes zbatimit të politikave.

Teksti në vijim është një shembull hipotetik i informacionit të kërkuar për kryerjen e vlerësimit të hapit të katërt të buxhetimit të përgjegjshëm për romët. Vlerësimi bazohet në shembullin e përdorur për të ilustruar hapat e mëparshëm.

Si në shembullin nga hapi i mëparshëm, qëllimi i programit buxhetor për arsimin bazë është rritja e nivelit të regjistrimit të fëmijëve të moshës përkatëse në arsimin bazë me 3 përqind, që në mënyrë efektive nënkupton regjistrimin e 10.500 fëmijëve më shumë. Objektivi në fjalë që i përkon politikës së integritit të romëve është rritja e shkallës së regjistrimit të romëve të moshës përkatëse në arsimin bazë me 12 përqind, duke përfaqësuar në mënyrë efektive regjistrimin e 900 fëmijëve romë më shumë.

Përcaktimi në buxhet për objektivin e përgjithshëm brenda programit buxhetor, sipas planifikimit, është 520,000, nga të cilat 10,720 (duke supozuar se janë miratuar rekomandimet nga shembulli në hapin e mëparshëm) janë caktuar për të arritur objektivin e politikës së integritit të romëve. Aktivitetet e planifikuara janë 'Fushatat për ndërgjegjësimin e prindërve' (me një buxhet prej 500,000 për të gjitha aktivitetet, 7,000 prej shumës në këtë rast është për romët), 'Identifikimi i fëmijëve të moshës së duhur' (me një buxhet prej 20,000 për të gjitha aktivitetet, 1,720 nga shuma janë caktuar për romët) dhe 'Ndihmë juridike për të marrë dokumentacionin civil' (me një buxhet prej 10,000 për të gjitha aktivitetet, nga ku 2,000 janë për romët).

Një analizë të zbatimit të buxhetit tregon se institucionet zbatuese nuk janë në dijeni se sa nga buxheti shpenzohet për përfshirjen e fëmijëve romë që duhet të regjistrohen në arsimin bazë. Megjithatë, mund të ketë informacion për zbatimin e buxhetit në përgjithësi, për rritjen e numrit të fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë dhe për numrin e romëve nga këta fëmijë. Këto të dhëna mund të jenë si në vijim:

| | |
|---|---------|
| ✿ Buxheti i zbatuar për rritjen e regjistrimeve në arsimin bazë | 450,000 |
| ✿ Rritja e numrit të fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë | 6,000 |
| ✿ Rritja e numrit të fëmijëve romë të regjistruar në arsimin bazë | 450 |

Natyrisht, do të ishte mirë të kishte informacion se sa shpenzohet aktualisht nga buxheti për të siguruar rritjen e regjistrimit të fëmijëve romë në arsimin bazë dhe ky duhet të jetë një nga rekomandimet. Në këtë rast, ky informacion nuk është i disponueshëm dhe për këtë arsye është i nevojshëm një përllogaritje e përafërt e shifrës se sa nga fondet janë shpenzuar për këtë qëllim. Kjo bëhet duke përllogaritur shpenzimet për përfitues $(450,000/6,000=75)$ dhe në përputhje me atë shifër, llogaritet sasia e shpenzimeve për zbatimin e politikës së integritit të romëve në lidhje me këtë objektiv të veçantë $(450 \times 75 = 33,750)$, që përfaqëson 7.5% të shpenzimeve totale). Megjithëse ky është vlerësimi më i mirë i mundshëm nga informacioni i disponueshëm, një numër arsyesh të mundshme mund të shkaktojnë devijimin nga vlera aktuale: numri i romëve mund të mos jetë i saktë (për shkak të çështjeve të vetëdeklarimit), llogaritja e vlerës absolute të

numrit të fëmijëve që duhen për arritjen e objektivave të përcaktuar mund të ketë ndryshuar për shkak të ndryshimeve demografike (vlera të reja të numrave absolutë përdoren për llogaritjen e përqindjes), kostoja e përfitimit për romët mund të ndryshojë nga kostoja mesatare (për shembull, për shkak të distancës gjeografike), etj.

Sidoqoftë, mund të arrihen një sërë përfundimesh mbi zbatimin e buxhetit mbështetur tek informacioni në dispozicion. Këto përfundime e përfshijnë çfarë vijon si më poshtë por nuk janë të kufizuara vetëm në to:

1. Ka nënshpenzime për objektivin e rritjes së numrit të fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë.
2. Nuk janë arritur objektivat, si për programin buxhetor ashtu edhe për politikën e integritit të romëve.
3. Nuk janë mbledhur të dhënat e nevojshme për të bërë një vlerësim të duhur të shpenzimeve dhe rezultateve.

Rrjedhimisht, mund të nxirren rekomandime të përshtatshme për përmirësimin e kapaciteteve përfundimtare, për rishikimin e aktiviteteve/masave që synojnë arritjen e rezultateve më të mira dhe përmirësimin e mbledhjes së të dhënave për shpenzimet buxhetore dhe për përfituesit (të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike).

Informacioni mbi shpenzimet duhet të krahasohet me tej me treguesit e efektit të arritur. Është e këshillueshme që të përfshihen zyrat e statistikës, të cilat duhet të jenë në gjendje të japin të dhëna (vlera) për treguesit e ndikimit (si psh. niveli i regjistrimit, arritjet në arsim, përqindja e braktisjes, përqindja e nxënësve që kalojnë në arsimin e mesëm etj.). Në këtë rast, nevojiten nivelet e regjistrimit në arsimin bazë për popullsinë e përgjithshme dhe për atë rome. Nëse zyrat e statistikës nuk janë në gjendje të japin këtë informacion, atëherë duhet të përdoret informacioni i marrë nga burime të jashtme dhe studime ekzistuese të disponueshme. Qëllimi është të bëhet një vlerësim i saktë i cili të mund të informojë procesin e buxhetimit në ciklet buxhetore pasardhëse.

5. Përmbledhja e buxhetimit të përgjegjshëm për romët

Hapi i fundit parashikon përpilimin e rezultateve, përfundimeve dhe rekomandimeve që rrjedhin nga të gjitha hapat e mëparshëm të buxhetimit të përgjegjshëm për komunitetin romë dhe paraqitjen e tyre në një dokument të vetëm të quajtur **“përmbledhje e buxhetimit të përgjegjshëm për romët”** (në vijim, përmbledhje e buxhetit). Informacioni dhe argumentat nga përmbledhja e buxhetit duhet të përdoren si një kontribut në procesin e buxhetimit, në mënyrë që buxheti të jetë më

i përgjegjshëm në drejtim të objektivave të politikës së integritit të romëve dhe rrjedhimisht ndaj objektivave korresponduese të programeve buxhetore përkatëse. Siç është përmendur më sipër, rekomandimet duhet të jenë sa më konkrete dhe të përfshijnë propozime sasiore. Analiza duhet të tregojë, për aq sa është e mundur, se çfarë është reale dhe ku janë të mundshme dhe të realizueshme ndërhyrjet.

Përmbledhja e buxhetit shërben për të përmirësuar procesin e buxhetimit duke dhënë rekomandime konkrete. Dokumenti duhet të ofrojë një analizë të situatës (siç është kryer në katër hapat e mëparshëm të procesit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët), në një formë të përmbledhur dhe propozime të realizueshme që çojnë drejt përmirësimeve konkrete. Gjatë përmbushjes së katër hapave duhet të vlerësohen se cilat rekomandime kanë më shumë gjasa të miratohen, në varësi të klimës politike, të fondeve në dispozicion, fazës së reformave dhe avancimit të sistemeve të financave publike dhe buxhetimit të programeve. Natyrisht, vlerësimi i realizimit të çdo rekomandimi të propozuar do të ishte shumë më realist nëse do të diskutohej dhe do të miratohej me zyrtarët dhe nëpunësit publikë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e buxhetimit (nga Ministria e Financave dhe nga ministritë përkatëse të linjës).

Përmbledhja e buxhetit e përgatitur përmes procesit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, mund të paraqitet dhe miratohet në këto forma:

- ✳ Një dokument i veçantë i miratuar ose nga qeveria, Pika Kombëtare e Kontaktit për Romët, organi ndërdisiplinor përgjegjës për integrimin e romëve, ose nga një grup pune/task forcë përgjegjëse për buxhetimin e përgjegjshëm për romët. Përmbledhja e buxhetit në këtë formë mund të përdoret për të informuar diskutimet parlamentare, dëgjesat publike, proceset e hartimit të politikave me pjesëmarrje dhe raste të tjera që i shërbejnë formulimit transparent dhe me pjesëmarrje të buxhetit publik.
- ✳ Si një pjesë përbërëse e Raportit të Zbatimit të Politikave për Integrimin e Romëve të miratuar nga Qeveria dhe i vënë në dispozicion të publikut. Si i tillë, ai mund të përdoret për të informuar politikën dhe përgatitjen e buxhetit të politikës për integrimin e romëve dhe buxhetit përkatës si pjesë e buxhetit publik.

Hapi i pestë i buxhetimit të përgjegjshëm për romët mbledh rezultatet, përfundimet, argumentet dhe rekomandimet e nxjerra nga analiza e plotë e bërë në hapat e mëparshëm në një përmbledhje të buxhetit, e cila pastaj shërben si kontribut për ciklin e ardhshëm të buxhetit publik.

- ✳ Një shtojcë bashkangjitur memorandumit të buxhetit (ose një dokumenti të ngjashëm) përgatitur nga Ministria e Financave që shoqëron buxhetin vjetor publik. Në këtë rast, përmbledhja e buxhetit i bashkëngjitet buxhetit vjetor publik dhe kështu merret parasysh gjatë çdo diskutimi që ka të bëjë me buxhetin vjetor publik.
- ✳ Një shtojcë e bashkangjitur propozimit të buxhetit për vitin e ardhshëm fiskal (ose afatmesëm) të miratuar nga Qeveria dhe paraqitur në Kuvend për diskutim si pjesë e diskutimit të propozimit të buxhetit vjetor (ose afatmesëm) publik.

Prezantimi i buxhetimit të përgjegjshëm për romët dhe garantimi që ai është i përshtatshëm për zbatimin e politikës së integritit të romëve, duke marrë parasysh rekomandimet e këtij procesi kur hartohet buxheti publik, me siguri do të dojë disa vite të realizohet. Përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm për romët si pjesë përbërëse e procesit të buxhetimit publik duhet të bëhet në mënyrë të kontrolluar, me përfshirjen graduale të më shumë programeve buxhetore në analizë dhe me përmirësimin e vazhdueshëm të vetë procesit dhe përmbledhjes së buxhetit si produkt i tij. Përmbledhja duhet të përmbajë gjithmonë e më shumë argumente dhe rekomandime të rëndësishme dhe të arritshme për buxhetin publik. Brenda procesit të përfshirjes graduale të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, ministrinë e linjës që janë në gjendje të planifikojnë siç duhet politikën për integrimin e romëve në buxhetin përkatës (bazuar në fakte që përfshijnë treguesit e duhur, mbledhjen e të dhënave përkatëse të shpenzimeve dhe të rezultateve, si dhe raportimin mbi rezultatet) duhet të kenë fonde të mjaftueshme për politikën e integritit të romëve të miratuara nga Ministria e Financave për vitin e ardhshëm buxhetor. Informacioni dhe rezultatet e analizës së buxhetimit të përgjegjshëm për romët për një vit të vetëm duhet t'u jepet palëve të interesuara përkatëse dhe të çojë në rishikimin e prioriteteve të shpenzimeve të qeverisë për të pasqyruar sa më saktë nevojat e romëve.

Përshkrimi i katër hapave të mëparshëm të buxhetimit të përgjegjshëm për romët përmban një sërë shembujsh të rekomandimeve të mundshme. Rekomandime të tjera të mundshme përfshijnë sa vijon më poshtë:

- ✳ Përfshirja e raportit të shpenzimeve për integrimin e romëve si pjesë e një raporti mbi një program buxhetor përkatës me qëllim që të pasqyrojë shpenzimet dhe arritjet.
- ✳ Përmirësimi i formatit të përshkrimit të programit buxhetor, i hierarkisë dhe sinkronizimit të objektivave të saj në përputhje me politikën e integritit të romëve.
- ✳ Pasqyrimi i politikës së integritit të romëve (Strategjia dhe Plani i Veprimit) në buxhetin publik në tërësi.
- ✳ Pasqyrimi i treguesve të politikave të integritit të romëve në treguesit e politikave të përgjithshme.
- ✳ Pasqyrimi i treguesve të buxhetit për politikën e integritit të romëve në treguesit e politikave të përgjithshme.
- ✳ Miratimi i një metodologjie përmes së cilës mund të gjurmohen me saktësi shpenzimet e politikave për integrimin e romëve brenda buxhetit publik, si p.sh. përmes prezantimit të një kodi të veçantë të buxhetimit.


- ✳ Riformulimi i politikave ekzistuese përkatëse në mënyrë që ato të mbështeten më shumë në performancën dhe efikasitetin, përfshirë përmes përmirësimit të qasjes ndaj romëve, ndryshimit të kriterëve për përfituesit për të siguruar akses për romët, përfshirjes së romëve në zbatimin, hartimin e veprimeve/masave specifike që kanë si objektive romët (sipas kushteve të tyre specifike), etj.
- ✳ Prioritizimi dhe/ose përmirësimi i masave ekzistuese që sigurojnë ndikim.
- ✳ Prezantimi i masave të reja me potencial më të lartë për të sjellë efektin e dëshiruar për romët dhe popullatën në përgjithësi.
- ✳ Eliminimi i masave të politikave që nuk sigurojnë (mjaftueshëm) ndikim, veçanërisht nëse ato janë të kushtueshme.
- ✳ Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit në planifikimin e buxhetit dhe të politikave në mënyrë që të adresojë më mirë nevojat reale të komunitetit, të cilat përndryshe mbeten të panjohura për nënpunësit publikë.
- ✳ Mandatimi zyrtar i Pikave Kombëtare të Kontaktit të Romëve për t'u angazhuar në procesin e buxhetimit në ministrinë përgjegjëse përkatëse dhe në përgjithësi (me Qeverinë dhe Parlamentin).

Roli i Pikave Kombëtare të Kontaktit të Romëve në procesin e buxhetimit duhet të jetë koordinimi dhe bashkëpunimi me ministrinë përkatëse dhe institucionet e tjera, duke përfshirë Ministrinë e Financave dhe Institutin e Statistikave, për të përgatitur buxhetimin e përgjegjshëm për romët dhe për të hartuar përmbledhjen e buxhetit. Pikat Kombëtare të Kontaktit të Romëve duhet të kenë gjithashtu rol zyrtar konsultativ/kontribues në procesin e buxhetimit në Qeveri dhe Kuvend për të prezantuar përmbledhjen e buxhetit, veçanërisht argumentet dhe rekomandimet përkatëse për buxhetin publik.

Përmbledhja e buxhetit, veçanërisht rekomandimet e saj të nxjerra nga një proces i mirëfilltë dhe i përgatitur profesionalisht i buxhetimit të përgjegjshëm për Romët, do të mbështetet në një vlerësim të thellë. Ajo do të japë detaje të mjaftueshme dhe do të bazohet në prova dhe argumente konkrete. Si e tillë, pritët që ajo të merret parasysh gjatë ciklit të buxhetimit publik dhe të ketë pasojë financiare, ndoshta përmes një mekanizmi të miratuar zyrtarisht.

Përmbledhja e buxhetit duhet të përmbajë një pasqyrë të planit aktual të shpenzimeve për zbatimin e integritit të romëve, siç është përcaktuar në hapin e parë të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, që i klasifikon programet buxhetore sipas rëndësisë së tyre për integrimin e romëve. Një pasqyrë e tillë informon nëpunësit publikë në mënyrë shumë koncize për alokimet dhe shpenzimet përkatëse të buxhetit për integrimin e romëve.

Më poshtë paraqitet përmbledhja nga shembulli hipotetik i përdorur, siç është nxjerrë nga klasifikimi i programeve buxhetore i kryer në hapin e parë:



Ky grafik tregon qartë se pjesa e buxhetit publik që kontribuon drejtpërsëdrejti në zbatimin e politikës për integrimin e romëve (klasifikuar si Kategoria 1) është shumë e vogël. Për më tepër, ajo nuk përdoret domosdoshmërisht vetëm për zbatimin e politikës për integrimin e romëve.

Pjesa e buxhetit publik që ka mundësi të kontribuojë në zbatimin e politikës për integrimin e romëve (klasifikuar si Kategoria 2), siç pritet, është pjesa më e madhe e buxhetit publik. Procesi i planifikimit të buxhetit publik duhet të sigurojë në masën më të madhe të mundshme që ky potencial të përdoret vërtetë për zbatimin e politikës së integritit të romëve.

Pjesa e buxhetit publik që nuk ka fare lidhje me politikën për integrimin e romëve (klasifikuar si Kategoria 0) është vërtet e madhe.

Hapat dy deri në katër të buxhetimit të përgjegjshëm për romët parashikojnë një analizë të thellë të programeve (të të gjithave ose disa të përzgjedhurave) të buxhetit të klasifikuara si Kategoria 1 ose Kategoria 2. Informacioni i mbledhur përmes analizës mund të përmirësojë alokimet buxhetore që i shërbejnë qëllimit të zbatimit të politikës së integritit të romëve. Për më tepër, analiza nxjerr në pah një sërë informacionesh shtesë të përshtatshme për ciklin e buxhetimit publik në lidhje me politikën për integrimin e romëve.

Kryerja e procesit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët përgjatë disa viteve do të mundësojë gradualisht analizën e më shumë programe buxhetore që janë drejtpërdrejt ose tërthorazi të rëndësishme për integrimin e romëve. Kjo do të përmirësojë më tej pasqyrën e buxhetit për integrimin e romëve dhe me shifra shumë më të sakta. Kjo do të bëjë të mundur vlerësimin më të mirë të alokimeve financiare dhe kontributit të shpenzimeve për integrimin e romëve. Rrjedhimisht, do të ishte e mundur të nxirren përfundime dhe propozime më të rëndësishme dhe më të realizueshme në lidhje me ndryshimet apo reformat e nevojshme për të promovuar më mirë integrimin e romëve dhe për të përdorur burimet publike në mënyrë më efektive dhe efektive. Qëllimi përfundimtar duhet të jetë arritja e integritit të plotë të komunitetit rom, siç përcaktohet në dokumentet strategjike.

Brenda procesit të buxhetimit të përgjegjshëm për romët, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet financimit nga IPA dhe nga burime të tjera të mundshme donatorësh. Dokumentet strategjike të donatorëve dhe buxhetet përkatëse mund të analizohen gjithashtu në përputhje me buxhetimin e përgjegjshëm për romët të propozuar në këto Udhëzime. Përafrimi i politikës për integrimin e romëve dhe i politikave kryesore të përgjithshme me dokumentet e programeve të IPA-s dhe donatorëve do të mund të siguronin ndikimin maksimal me fondet në dispozicion për integrimin e romëve dhe shmangien e rrezikut të mbivendosjes së burimeve.

Përmbledhja e buxhetit duhet të përgatitet çdo vit. Vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse duhet të mbështeten tek informacioni i marrë përmes një procesi monitorimi të vazhdueshëm, i cili duhet gjithashtu të përmirësohet me kalimin e kohës.

Trajnimi, rritja e kapaciteteve dhe mbështetja

Rritja e ndërgjegjësimit dhe e ndjeshmërisë së nëpunësve civilë nëpërmjet udhëzimeve të buxhetit nuk do të ishte e mjaftueshme për të promovuar me sukses buxhetimin e përgjegjshëm për romët. Aktorëve pjesëmarrës në këtë proces iu kërkohen aftësi dhe kapacitete të ndryshme të cilët duhet të fuqizohen përmes trajnimeve.

Rekomandime për trajnimet dhe grupet e synuara:

- ⊗ **Nëpunësit administratës së lartë:** a) sekretarë të përgjithshëm, b) drejtorë buxheti, c) drejtorë dhe/ose përgjegjës të departamenteve të politikave të sektorëve prioritarë, d) komisioni parlamentar i buxhetit.
- ⊗ **Personat e kontaktit në nivel kombëtar për romët dhe organet ndërdisiplinore përgjegjëse për integrimin e romëve.**
- ⊗ **Ministritë e linjës që merren me politikat sektoriale për integrimin e romëve** (me përfshirjen graduale të ministrive të tjera): a) njësitë strategjike, b) personeli i zyrës së financave/ buxhetit, c) juristë, d) personeli i drejtorisë përgjegjëse për një program buxhetor, masë apo projekt specifik.
- ⊗ **Nëpunësit civilë përgjegjës për programimin e fondeve të BE-së:** autoriteti i menaxhimit, autoriteti i certifikimit, autoriteti i monitorimit, etj.
- ⊗ **Analistët në Ministrinë e Financave përgjegjës për politikat në sektorët prioritarë për integrimin e romëve** (me përfshirjen graduale të analistëve të tjerë të buxhetit) dhe mundësisht analistët e caktuar veçanërisht si përgjegjës për buxhetimin e përgjegjshëm për komunitetin rom.

 **ROMA INTEGRATION 2020**
Regional Cooperation Council

Roma Integration 2020 Action Team Office
Ruzveltova 61, 11000 Belgrade, Serbia
T: +381 (11) 4046 891 F: +381 (11) 4046 894
E: romaintegration2020@rcc.int



rcc.int/romaintegration2020



RomaIntegration2020



RomaIntegration



RCCSec

 Regional Cooperation Council

Regional Cooperation Council Secretariat

Trg Bosne i Hercegovine 1/V
71000 Sarajevo, Bosnia and Herzegovina
T +387 33 561 700 F +387 33 561 701 E rcc@rcc.int



rcc.int



RegionalCooperationCouncil



rcc.int



RCCSec



RegionalCooperationCouncil

Roma Integration 2020 is co-funded by:



European
Union



OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS



Regional Cooperation Council